



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

Katalogu 2010



DOGANA E KOSOVËS



POLICIA E KOSOVËS



DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË
EMERGJENCAVE



SHËRBIMI I KORREKTUESVE

Punuar nga:

QENDRA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE , EDUKIM DHE ZHVILLIM - QKSPEZH

Katalogu i kurseve

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| Prezantimi i Qendrës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim | 4 |
| Paraqitja e Misionit | 5 |
| Parathënia e drejtorit..... | 6 |
| POLICIA E KOSOVËS..... | 7 |
| I. TRAJNIMI THEMELOR - 12 JAVOR..... | 7 |
| a) Policia e Përgjithshme | 7 |
| b) Shkathësitë Operative të Policit | 7 |
| c) Armët e zjarrit | 8 |
| d) Trajnimet e Trafikut | 8 |
| Tabela – Pasqyra e Trajnimit Themelor | 9 |
| Trajnimi themelor i PK-së | 10 |
| II. KURSET E AVANCUARA DHE TË SPECIALIZUARA | 11 |
| 1. KURSET E TRAFIKUT | 11 |
| • Operimet themelore me automjetet emergjente | 11 |
| • Menaxhimi i komunikacionit dhe hetimet e aksidentit | 12 |
| • Kursi për laser dhe alkotestues | 13 |
| • Kursi Siguria në komunikacion..... | 14 |
| • Ngasja e automjetit WV Golf 5-1.9. | 15 |
| 2. KURSET PËR ARMË TË ZJARRIT..... | 16 |
| • Trajnimi me armë zjarri Glock 9mm..... | 16 |
| • Trajnimi me pushkë automatike AK-47 | 17 |
| • Trajnimi për Instruktor për armë zjarri | 18 |
| • Trajnimi themelor dhe i avancuar për armë zjarri MP5..... | 19 |
| 3. KURSET E SHKATHËSIVE OPERATIVE TË POLICIT – SHOP | 20 |
| • Përgjegjësi i parë emergjent | 20 |
| • Kursi për ricertifikim | 21 |
| 4. TRAJNIMET E SPECIALIZUARAT | 22 |
| • Kursi themelor i hetimeve të krimit | 22 |
| • Kursi i avancuar i hetimeve të krimit..... | 23 |
| • Kursi i specializuar i hetimit të krimit..... | 24 |
| • Trafikimi me qenie njerëzore | 25 |
| • Delikuenca e të miturve | 26 |
| • Kursi për hetime të dhunës familjare | 27 |
| • Kursi për droga dhe narkotik | 28 |
| • Kursi themelor për qendrat e mbajtjes | 29 |
| • Kursi i vëzhgimit | 30 |
| • Kursi i inteligjencës | 31 |
| • Kursi “Krim teknikët e vendit të ngjarjes”..... | 32 |
| • Kursi “Përcjellja e personave me rrezikshmëri të lart”..... | 33 |
| III. MENAXHIMI DHE MBIKËQYRJA | 34 |
| • Kursi i vijës së parë të menaxhimit | 34 |
| • Kursi i vijës së mesme të menaxhimit | 35 |
| • Sjellja me njerëz dhe shkathësitë e punës në zyre | 36 |
| • Analiza e nevojave të trajnimit | 37 |
| • Menaxhimi i lartë..... | 38 |

| | |
|---|-----------|
| IV. STANDARDET E TRAJNIMEVE..... | 39 |
| • Të drejtat e njeriut | 39 |
| • Komunikimi jo-verbal dhe menaxhimi i stresit | 40 |
| • Barazia gjinore | 41 |
| • Programi për aftësimin për instruktor | 42 |
| • Udhëheqësi, krijimi i ekipit dhe menaxhimi i konfliktit | 43 |
| • Instruktori parësor i ushtrimeve në teren | 44 |
| • Instruktori i ushtrimeve në teren | 45 |
| V. POLICIA KUFITARE..... | 46 |
| • Kursi themelor i policisë kufitare | 46 |
| • Kursi i avancuar i policisë kufitare | 47 |
| • Kursi i specializuar i policisë kufitare. | 48 |
| DOGANA E KOSOVËS | 49 |
| I. TRAJNIMET E AVANCUARA..... | 49 |
| • Trajnimi për trajtimin e personave diplomatik | 49 |
| • Trajnimin mbi TARIK-un (Moduli 1) | 50 |
| • Trajnimin mbi TARIK-un (Moduli 2) | 51 |
| • Trajnimi “Procedurat doganore me ndikim ekonomik” | 52 |
| • Trajnimi i specializuar për kontroll të automjeteve, bagazh dhe pasagjerë | 53 |
| • Trajnimi për kontrollin e specializuar të autobusëve | 54 |
| • Trajnimi “Komunikimi jo-verbal” | 55 |
| • Trajnimi për ” Të drejtat e njeriut” | 56 |
| • Trajnimi “Kontrolli i aeroplanëve” | 57 |
| • Trajnimi “Kontrolli i specializuar i kamionëve, maunave me rimorkio dhe autoboteve” | 58 |
| • Trajnimi themelor për “Arrest dhe ndalim” | 59 |
| DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE – (DME)..... | 60 |
| I. TRAJNIMI THEMELOR..... | 60 |
| • Trajnimi themelor 2 javor për zjarfikëje dhe shpëtim | 60 |
| • Trajnimi themelor 5 javor për zjarrefikëje dhe shpëtim..... | 61 |
| II. TRAJNIMET E AVANCUARA..... | 62 |
| • Trajnimi i avancuar për zjarfikëje dhe shpëtim | 62 |
| • Kursi i specializuar për ndihmë të parë..... | 63 |
| • Kursi “Zjarret e brendshme” | 64 |
| • Kursi “Aksidentet e trafikut rrugor” | 65 |
| • Kursi “Përdorimi i aparateve për zjarfikëje”. | 66 |
| • Kursi për GPS | 67 |
| • Kursi për inspektor të DME-së | 68 |
| • Zjarret fushore-malore..... | 69 |
| • Trajnimi për shuarjen e zjarreve në objektet e larta..... | 70 |
| • Kursi ”Hetimet e zjarrit” | 71 |
| SHËRBIMI KORREKTUES..... | 72 |
| I. TRAJNIMI THEMELOR..... | 72 |
| • Trajnimi themelor për korrektues | 72 |
| • Trajnimi themelor për stafin civil | 73 |
| Kurset e mbajtura në QKSPEZH..... | 74 |
| Kontaktet me QKSPEZH..... | 78 |

Prezantimi i Qendrës Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim

Qendra Kosovare për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) ka evoluar nga ish Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK). Kjo e fundit është formuar në Shtator të 1999 nga Shtylla e III e



Ndërtesa Kryesore

UNMIK-ut, ndryshe e njohur si Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë, me synim të krijimit të organizatës moderne policore e aftë



Konviktet e studentëve

për kthimin e besimit të popullit në këta zbatues të ligjit duke bërë që ata të veprojnë si 'shërbim policor' e jo vetëm si 'forcë policore', duke aplikuar në mënyrë efektive principet e policimit me respektim dhe bashkëpunim të komunitetit të gjerë ku shërbejnë.



Poligoni i gjuajtjes

QKSPEZH-i është formuar në janar 2006 dhe gjendet në Vushtrri. QKSPEZH ka kapacitete dhe burime të mjaftueshme që në mënyrë të suksesshme të ofroj shërbime të përbëra trajnuese për të gjitha Agjencitë të Sigurisë Publike në Kosovë. Ajo posedon 30 klasë me hapësirë të mjaftueshme për trajnim dhe mësim të 1000 studentëve në çdo kohë.



Kuzhina

PARAQITJA E MISIONIT

QKSPEZH synon ofrimin e trajnimeve me kualitet të lartë profesional në menaxhmentin institucional, dhe në distribuimin e burimeve mes të të gjitha Agjencitë e Sigurisë Publike në Kosovë. QKSPEZH është gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e standardeve cilësore profesionale për shkollimin e personelit të Agjencive për Siguri Publike në Kosovë.



PARATHËNIA E DREJTORIT

Shkathtësitë e vëna për përmbushjen e kërkesave të punëve përditshme të zyrtarëve të sigurisë publike është në një gjendje konstante të rrjedhjes. Me konceptet e reja të ndryshimeve, ne duhet të koncentrohemi në proceset afatgjata mësimore. Themelimi dhe përmirësimi i sistemit të trajnues dhe mësimor të Agjencive të Sigurisë në Kosovë është analizuar dhe rishikuar nga Qeveria dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Në lidhje me zhvillimin profesional të Institucioneve të Sigurisë në Kosovë, ish Shkolla e Shërbimit Policorë të Kosovës e themeluar nga ana e Misionit të OSBE-së është transferuar në një institucion të ri që është Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH). Arsimiti i anëtarëve të Agjencive të Sigurisë Publike (ASP) është një prej komponentëve kryesorë në zhvillimin dhe themelimin e sistemit modern dhe të qëndrueshëm të sigurisë në Kosovë.

Agjencitë nga ana profesionale janë të trajnuara në përputhje me standardet ndërkombëtarisht të pranura në adresimin e sfidave dhe kërcënimeve, të cilat kanë evoluar dhe kanë marrë tjetër dimension. Krimi i organizuar, terrorizmi ndërkombëtarë dhe format e tjera të dukurive negative na kanë bërë të mendojmë se si t'u kundërvihemi atyre në të ardhmen.

Arsimi i të rinjve është një nga prioritetet e institucioneve Kosovare. Studimet mbi Sigurinë Publike është një disiplinë kritike ku Kosova po ballafaqohet me mungesën e ekspertëve profesional. Nevoja për ekspertë të tillë është e rëndësishme së veçantë për shoqërinë kosovare dhe për institucionet publike të saja. Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme po synon mundësimin dhe ofrimin e programit i cili do të ndihmojë në arsimimin e qytetarëve të Kosovës në këtë lëmi. Kjo do të arrihet me formimin e këtyre institucioneve të reja të arsimit të lartë Studimeve të Sigurisë Publike. Në të vërtetë të gjitha trajnimet e Sigurisë Publike janë të zhvilluara në temën e përbashkët të njohurisë profesionale dhe të zhvillimit të shkathtësive.

Qendra, është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe të mbështetjes teknike të të gjitha Agjencive të Sigurisë Publike siç janë Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Korrektuesit e Kosovës dhe Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave, prandaj ngjashmëritë e vërejtura në lidhje me metodologjinë e punës të arsimit të personelit janë bërë pas identifikimit të nevojës për unifikimin e zhvillimit profesional të institucioneve të sigurisë publike.

Ndërtimi i kapacitetit të stafit të Qendrës përmes trajnimeve dhe kurseve profesionale si dhe përforcimi i bashkëpunimit me OSBE-në dhe institucionet tjera ndërkombëtare është bërë me qëllim të përparimit profesional.

Qendra synon që të krijoj dhe të mbaj marrëdhënie të mira me institucionet e ngjashme në regjion dhe më gjerë, të shkëmbej përvojat dhe të zhvilloj rjetet regjionale dhe ndërkombëtare.

Taibe Canolli
U.D. Drejtor

Policia e Kosovës



Trajnimi Bazik - 12 Javë

Trajnimi i cili ofrohet në Kursin bazik ka për synim ndërtimin e një Policie profesionale, të disiplinuar dhe të orientuar nga demokracia (me theks të veçantë në 'Shërbim') për komunitetet në Kosovë. Pas një periudhe prej dymbëdhjetë (12) javësh, studentët gradohen në sektorin e Policisë së Kosovës.

Divizioni i Trajnimit Bazik ka katër (4) seksione të ndryshme:

a) Policia e përgjithshme



Ky seksion jep bazat e trajnimit bazik për rekrutët e rinj policor. Theks të veçantë i është vënë temës së të drejtave të njeriut dhe të policimit demokratik, procedurave të trafikut dhe të patrullimit, çështjeve ligjore, shkrimit të raportit dhe teknikat e intervistimit gjatë hetimeve të krimit. Lëndët kryesore janë të ndara në 58 tema. Këto tema, në pajtim me teknikat moderne mësimore, janë të integruara përmes programit bazik.

b) Shkathësitë Operative Policore



Ky seksion përbëhet prej 3 njësive kryesore të trajnimit. Këto janë Taktikat Mbrojtëse, Trajnimi Taktik dhe trajnimi Fizik. Seksioni ofron trajnim në bazat e vetëmbrojtjes, kontrollimit të turmës, prangimit, shufrës policore dhe të teknikave të ndryshme të arrestimit, si dhe trajnimet për ndihmë të parë dhe mina. Trajnimi taktik u mëson policëve, korrektuesve dhe doganierëve sigurinë dhe taktikat, siç janë ndalja e veturave me rrezikshmëri të lartë, kontrollimin e godinave dhe situatat tjera taktike të cilat i hasin pjesëtarët e agjencive të lartpërmendura. Trajnimi Fizik është për zhvillimin dhe rritjen e aftësisë fizike të studentëve.

c) Armët e zjarrit



Ky seksion i ushtron studentët e Kursit Bazik 12 javor në godinat e QKSPEZH-it dhe në poligonin në Obiliq. Trajnimi është i ndarë në pjesën teorike dhe në atë praktike. Studentët do të trajnohen për përdorimin Pistoletës Glock 19, sigurinë e armës së zjarrit, forcën vdekjeprurëse, të drejtat e njeriut dhe temat tjera në lidhje me armët e zjarrit. Skenarët e simuluar në kompjuter jepen në Simulatorin e Armës së Zjarrit (FATS)

i cili gjendet në QKSPEZH. Trajnimi me armë zjarri përbëhet prej më tepër se 80 orëve të trajnimit.

d) Sektori i Trajnimeve të Trafikut

Sektori i Trajnimeve të Trafikut është i ndarë në dy pjesë, trajnimin bazik dhe të specializuar. Trajnimi Bazik përfshinë trajnimin teorik dhe praktik:

Kurset shtrihen prej Kursit Bazik të Trajnimit të Ngasësit deri te Kursi i Avancuar i Operimit Emergjent të Veturës – Veturat e Blinduara dhe po ashtu përfshijnë kursin e ngasjes defensive dhe ngasjes në kushtet dimërore. Trajnimi për trafikun gjithashtu ka komponentin solid në hetimet e aksidenteve.



| Kursi Bazik i Trajnimit | | Kohëzgjatja |
|---|--|--------------------|
| Dymbëdhjetë (12) javë | | |
| Policia e Përgjithshme | | 214 orë |
| | | 70 orë |
| Shkathësitë Operative Policore: | <ul style="list-style-type: none"> • Taktikat mbrojtëse (29 orë) • Trajnimet fizike (30 orë) • Trajnimi për ndihmë të parë (11 orë) | |
| Trajnimi për armë të zjarrit | | 50 orë |
| Trajnimi për ngasës | | 35 orë |
| Punë administrative dhe shërbime tjera (prezantimi, njoftimi, logjistika, etj) | | 44 orë |
| Ushtrimi praktik (parada, etj) | | 27 orë |
| Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq | | 2 orë |
| Të gjitha testet e trajnimit themelor | | 26 orë |
| Stërvitje | | 12 orë |

Policia e Kosovës

I. Trajnimi themelor (12 javor)

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 52 ditë gjatë Kursit bazik 12 javor |
| Kushtet paraprake: | Kandidatët e suksesshëm për Policinë e Kosovës |
| Grupi i synuar: | Rekrutët policorë në trajnim |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit. Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas mbarimit të suksesshëm të trajnimit bazik policor në policimin e përgjithshëm dhe kalimit të suksesshëm të serisë së testeve, polici i ri mund t'i marrë rolet dhe përgjegjësitë të policit me përvojë.

Përshkrimi i kursit:

Kursi është i dizajnuar t'i pajis studentët me shkathtësitë themelore të cilat kërkohen prej policit. Ofron bazat e trajnimit bazik për rekrutët e rinj. Theks të veçantë i është vënë temës së të drejtave të njeriut dhe detyrave të policisë në shoqëri demokratike, procedurave të trafikut dhe të patrullimit, çështjeve ligjore, shkrimit të raportit dhe teknikat e intervistimit gjatë hetimeve të krimit. Lëndët kryesore janë të ndara në 58 tema. Këto tema, në pajtim me teknikat moderne mësimore, janë të integruara përmes programit bazik.

Mësimet janë të dizajnuara që t'u ofrojnë studentëve mundësi për aplikimin e teknikave të mësuara gjatë kursit në situatat praktike ashtu edhe teorike.

Gjatë kohëzgjatjes së kursit studenti do të testohet me kuize me shkrim dhe me testet mujore. Veç kësaj ekziston edhe testi final në fund kursit.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- dinë rolin dhe detyrën kryesore të Policit dhe të jenë në shërbim të popullit,
- zbatojnë ligjin me përpikëri dhe të jenë çdo herë të informuar mbi ndryshimet mbi ligjin penal dhe kodin e procedurës penale,
- zbatojnë procedurat e arrestimit dhe paraburgimit, intervistimit, etj,
- identifikojnë provat materiale si dhe hetimin e veprave të ndryshme penale,
- zbatojnë aftësitë operative gjatë përdorimit të nevojshëm të forcës për kryerjen e detyrave (përdorimin e shufrës, prangimin, sprejin, teknikat e buta dhe të forta duarthata, etj),
- vlerësojnë situatat se kur duhet të përdoret forca e nevojshme, ligjore dhe proporcionale,
- zbatojnë procedurat e nevojshme të përdorimit të armëve të zjarrit, etj.

II. Kurset e avancuara dhe të specializuara

1. Kurset e Trafikut

Titulli i kursit: Operimet themelore me automjet emergjent

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 7 ditë (49 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët e PK-së të cilët posedojnë patentë shoferi të vlefshëm |
| Grupi i synuar: | Oficerët e PK-së, njësia e zjarrfikëjes dhe shpëtimit, ambulanca, klientë të tjerë. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i Kursit. Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit me sukses të kënaqshëm të Trajnimit themelor për automjete emergjente Oficerët e PK-së dhe oficerët e Shpëtimit do të jenë në gjendje të operojnë me automjete motorike në mënyrë të sigurt dhe efikase.

Përshkrimi i kursit:

Qëllimi i trajnimit themelor me automjete emergjente është që t'i trajnoj oficerët e zbatimit të ligjit për operim të sigurt dhe efikas të automjeteve motorike.

Theksi vendoset në parimet dhe teknikat, veçanërisht ligjet e lëvizjes, dinamikat e automjetit dhe reagimi i vozitësit. Parimet dhe teknikat shpjegohen në klasë para se tu lejohet studentëve të marrin pjesë në kryerjen reale të ushtrimeve praktike. Nën mbikëqyrjen dhe udhëzimin e afërt, studentët mësojnë t'i njohin kufizimet e tyre personale, si dhe kufizimet e automjetit.

Pjesëmarrësit do t'u nënshtrohen testeve (teori, poligon dhe në demonstrim praktikë në komunikacion).

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- njohohen me karakteristikat e përgjithshme të automjetit zyrtar (pjesët e automjetit, kontrollimin dhe mirëmbajtjen e automjetit zyrtar, etj),
- operojnë në mënyrë profesionale dhe të pavarur me automjetet zyrtare,
- zbatojnë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me ngasjen emergjente dhe komunikacionit rrugor në përgjithësi,
- dinë ti përdorin pajisjet sinjalizuese në rastet emergjente,
- ngasin automjetet zyrtare në mënyrë të sigurt, në situata me rrezikshmëri (kthesa të rrezikshme, tejkalime, etj), si dhe në kushte të ndryshme klimatike (shi, borë, akull, etj)

Titulli i kursit: Menaxhimi i komunikacionit dhe hetimi i aksidentit

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 4 javë (140 orë) |
| Kushtet paraprake: | Kandidatët duhet të kenë të kryer Kursin themelor për policë |
| Grupi i synuar: | Oficerët e PK-së, stafi civil i OSBE-së të cilët punojnë në Sektorin e Komunikacionit |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kps-kp.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që t'i pajisë zyrtarët me shkathtësi të nevojshme për të bërë hetimin e tërësishëm të aksidenteve të komunikacionit rrugor dhe me përdorimin e shkathtësive të tyre të zvogëloj dukshëm numrin e aksidenteve të komunikacionit rrugor.

Përshkrimi i kursit:

Ky modul është i dizajnuar për t'i përgatitur oficerët për menaxhimin e aksidenteve të komunikacionit në vendin e ngjarjes dhe hetimin e detyrave speciale. Trajnimi i mëparshëm i hetimit të aksidenteve përforcohet në mënyrë që të bëhet një qasje e njëjtë dhe profesionale për këtë fushë të hetimeve.

Oficerët e PK-së trajnohen për identifikimin, sigurimin, dhe mbledhjen e dëshmimeve, dhe informatave në lidhje me aksidentin, regjistrimin dhe interpretimin e informatave në mënyrë që të bëhet analiza e hollësishme e ngjarjes së para aksidentit, duke i bërë matjet e nevojshme në mënyrë që të jenë në gjendje të përgatisin skicën që na tregon në mënyrë të saktë diagramin proporcional që përfaqëson vendin e ngjarjes, duke fotografuar vendin e ngjarjes të aksidentit të komunikacionit, dhe një përshkrim të përgjithshëm për ligjet, të cilat janë drejt për drejt të lidhura me hetimin e aksidenteve të komunikacionit..

Oficerët gjithashtu do të informohen për pajisjen e alkotestuesit më të fundit dhe zbuluesit të shpejtësisë. Ata gjithashtu do të trajnohen se si t'i ekzaminonjë dhe zbulonjë veprat penale në lidhje me pajisjen e tahogرافit.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- dinë rolin dhe detyrën e policit në vendin e ngjarjes (ndarja e detyrave),
- zbatonjë metodat përkatëse mbi matjen dhe skicimin e vendit të ngjarjes,
- përmbledhin dhe ruajnë dëshmitë e siguruar nga vendi i ngjarjes,
- zotërojnë shkathtësi mbi ofrimin e ndihmës së parë të lënduarve,
- respektojnë konfidencialitetin dhe çështjet etike,
- vlerësojnë situatën në vendin e ngjarjes dhe sipas nevojës bashkëpunojnë me organet tjera kompetente.

Titulli i kursit: Laseri dhe alkotesti

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 2 ditë (14 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët e PK-së të cilët e kanë të kryer Kursin themelor për policë. |
| Grupi i synuar: | Oficerët e PK-së. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit. Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Ky kurs është i dizajnuar t'i përgatisë oficerët me njohurinë e përdorimit të pajisjes së laserit dhe alkotestit. Qëllimi i këtij mësimi është që t'u japë studentëve një përshkrim të përgjithshëm të Parimeve & Procedurave për Pajisjen për Matjen e Shpejtësisë dhe matjes së alkoolit në Kosovë.

Përshkrimi i kursit:

Policia e Kosovës është duke e bërë kontrollin e shpejtësisë dhe matjen e sasisë së alkoolit tek ngasësit në zonat e tyre të përgjegjësisë. Mënyra më efektive e matjes së shpejtësisë dhe përqindjes së alkoolit tek ngasësit në organizim është duke e përdorur pajisjen laserike dhe alkotestuesin. Përdorimi manual i tyre është më i sigurt dhe i saktë.

Në këtë kurs oficerët do të informohen shkurtë për pajisjen e alkotestuesit më të fundit dhe zbuluesit të shpejtësisë.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- përdorin pajisjet për matjen e shpejtësisë së automjeteve si dhe të përqindjes së alkoolit në trup,
- identifikojnë pozitat e rregullta të vendosjes së pajisjeve,
- vlerësojnë situatën se kur duhet të përdoret alkotesti,
- sqarojnë rregullat dhe procedurat e marrjes së mostrave të ajrit dhe marrjes së informatave.

Titulli i kursit: Siguria në komunikacion

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të jenë zyrtarë policor |
| Grupi i synuar: | Vetëm zyrtarët policor |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësit të njoftohen me dispozitat ligjore nga Ligji për sigurinë në komunikacion, me theks të veçantë në ndryshimet dhe plotësimet nga ky ligj.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do të njoftohen me dispozitat ligjore nga Ligji për sigurinë në komunikacion, me theks të veçantë në ndryshimet dhe plotësimet nga ky ligj. Mënyrën e rregullimit të komunikacionit në rrugë të hapur dhe në vendbanim, me aksent të veçantë në udhëkryqe. Ndalja e dhunshme e automjeteve. Plotësimin e formularëve që policët i përdorin gjatë kontrollimit dhe rregullimit të komunikacionit si edhe njohuri rreth përdorimit të llojeve të ndryshme të laserëve dhe alkotesteve.

Pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit teorik dhe praktik.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- kenë njohuri mbi ligjin e komunikacionit
- kenë njohuri mbi mbushjen e formularëve
- punojnë me Laser dhe Alkotest
- rregullojnë përparësinë e kalimit në udhëkryq dhe të jenë në gjendje të bëjnë një pikë kontrolluese të sigurt.

Titulli i kursit: Ngasja e automjetit WV Golf 5 1.9D

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 ditë (7 orë) |
| Kushtet paraprake: | Duhet të jenë zyrtarë policor dhe të pajisur me patentë shoferi |
| Grupi i synuar: | Vetëm zyrtarët policor |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit. Ext 271 E-mail: course-admin@kps-kp.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësit të njohohen me ngasjen e këtij automjeti.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do të njohohen me të gjitha karakteristikat e Golf 5 si dhe me mënyrën e ngasjes së sigurt të këtij automjeti.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- kenë njohuri mbi kontrollimin e jashtëm të automjetit
- njohohen me ngasjen e këtij automjeti
- kenë njohuri mbi kontrollimin e vajit, vajit të frenave, motorit etj.

2. Armët e zjarrit

Titulli i kursit: Trajnimi me armë zjarri - Glock 9m

| | |
|----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 10 ditë gjatë Kursit Bazik 12 javor |
| Kushtet paraprake: | Kandidatët e suksesshëm për Policinë e Kosovës, Kandidatët e suksesshëm për Shërbimin Korrektues |
| Grupi i synuar: | Rekrutët policorë në trajnim, rekrutët për shërbimin korrektues |
| Kontakti në QKSPEZH | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Ky kurs është i dizajnuar t'i përgatisë pjesëmarrësit që të jenë në gjendje që në mënyrë të sigurt të manipulojnë dhe ta përdorin armën standarde të Policisë së Kosovës.

Përshkrimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që t'i mësoj rekrutët e rinj me parimet themelore të përdorimit të armës së zjarrit. Kursi është i përbërë prej disa orëve të teorisë për armët e zjarrit dhe përfshinë të mësuarit e: sigurisë së armës së zjarrit, manipulimin/operimin, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen.

Pastaj, studenti merr mësim nga Sistemi i simulimit të trajnimit me armë zjarri (FATS). Kjo është një përvojë praktike në gjuajtje të caqeve, si të siluetave ashtu edhe të gjuajtjes në qendër. Me përfundim të kësaj fushe të trajnimit, studenti do të vazhdoj në poligonin e qitjes me pistoletë ku ata do të rrisin shkathtësitë e tyre me municion të vërtetë.

Siguria në poligon është e theksuar së bashku me teknikat korrekte të qitjes së nevojshme për përdorim dhe kualifikimin për armë të shërbimit. Pastaj, është hyrja në caqet e shumta dhe gjuajtja në lëvizje. Për ta përfunduar me sukses trajnimin, studenti duhet t'i kaloj këto teste nga armët e zjarrit: kualifikimi nga pistoletë e SHPK-së, testi me shkrim dhe vlerësimi i vendimmarrjes në FATS.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- zotërojnë shkathtësi në rastet e qitjes me dukshmëri të dobët,
- manipulojnë me armë zjarri nga distanca të afërta dhe të largëta si dhe përdorimin e mburojave,
- dinë të gjitha karakteristikat e armës së zjarrit (Glock 9mm), të manipulojnë çmontojnë, montojnë, pastrojnë etj.
- zbatojnë dispozitat ligjore lidhur me përdorimin e armëve të zjarrit.

Titulli i kursit: Trajnimi me pushkë automatike AK- 47

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe të Shërbimit Korrektues cilët kanë kryer kursin e trajnimit bazik |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët janë të angazhuar në Njësitin e Policisë së vijës kufitare dhe të kufirit administrativ, ROSU, si dhe agjencitë tjera |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit :

Pas përfundimit me sukses të trajnimit studentët do të jenë në gjendje të përdorin AK-47-in në mënyrë të sigurt dhe praktike si pjesë e pajisjes së tyre operative.

Përshkrimi i kursit:

Studentët do të njoftohen me AK-47-in, origjinën, specifikat dhe informatat e nevojshme teknike. Atyre do t'u shpjegohet si vepron arma, dhe identifikimi i dallimit mes municionit shkollor dhe municionit të shërbimit.

Ata do të mësohen se si ta çmontojnë dhe ta montojnë AK-47-in, dhe të shpjegojnë rëndësinë e mirëmbajtjes dhe pastrimit, pozitat e gjuajtjes me AK-47, mënyrat e aplikimit të Parimeve të Shenjëtariisë (kapje të mirë, nivelimi i shënjestrave, kontrollimi i këmbëzës dhe përcjellje e mëtejme); demonstrojnë si ta kontrollojnë veturën dhe si t'i kontrollojnë personat me AK-47; demonstrojnë gjuajtjen me AK-47 në poligonin e gjuajtjes.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- zotërojnë shkathtësi në rastet e çmontimit dhe montimit të pushkës automatike AK-47 dhe ta dinë rëndësinë e mirëmbajtjes,
- manipulojnë me pushkë automatike nga distanca të afërta dhe të largëta si dhe përdorimin e mburojave,
- dinë të gjitha karakteristikat e pushkës automatike (AK-47),
- zbatojnë dispozitat ligjore gjatë bastisjes së personave dhe kontrollimin e veturave me AK-47.

Titulli i kursit: Instruktor i armëve të zjarrit

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 3 javë (105 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit duhet të kenë të kryer me sukses Kursin e zhvillimit të trajnerit ose të kenë kualifikim tjetër nga trajnimi përkatës |
| Grupi i synuar: | Instruktorët e PK-së. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit me sukses të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të udhëzojnë dhe trajnojnë në mënyrë kompetente, në përdorimin e armëve të dhëna, sipas parimeve dhe kriterit të testimit që i përkasin PK-së.

Përshkrimi i kursit

Moduli është i dizajnuar ti pajisë oficerët me njohuri të nevojshme për ti udhëzuar në përdorimin e armëve të zjarrit në mënyrë efektive. Kursi shfrytëzon edhe teorinë edhe mësimet praktike.

Kursi përbëhet nga mësimet në udhëheqjen e poligoneve, shenjëtarisë dhe shkathtësive të trajnimit.

Kandidatët gjithashtu trajnohen edhe në shfrytëzimin e FATS-it. Kursi gjithashtu përfshinë informatat për aspektet ligjore të përdorimit të armës së zjarrit dhe kandidatët gjithashtu trajnohen në ndihmë të parë në mënyrë specifike për armët e zjarrit.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- zotërojnë shkathtësi në trajnimin e pjesëmarrësve për qitje me armë në situata dhe rrethana të ndryshme,
- trajnojnë pjesëmarrësit me mënyrën e manipulimit me armë zjarri nga distanca të afërta dhe të largëta si dhe përdorimin e mburojave,
- dinë të gjitha karakteristikat e armës së zjarrit (Glock 9mm), të manipulojnë çmontojnë, montojnë, pastrojnë etj.
- zbatojnë dispozitat ligjore lidhur me përdorimin e armëve të zjarrit.

Titulli i kursit: Trajnimi themelor MP5

| | |
|----------------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit janë selektuar nga Departamenti i Trajnimit në Prishtinë |
| Grupi i synuar: | Ky modul u mbahet prestatëve të PK-së, zyrtarëve të Shërbimit Korrektues, trup-rojeve të VIP-ve. |
| Mbajtja e kursit të parë: | Janar 2004 |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Synimi i këtij kursi është që të trajnoj pjesëmarrësit në përdorimin e sigurt dhe praktik të Heckler dhe Koch MP5-it. Pas përfundimit të suksesshëm të këtij moduli, nga pjesëmarrësit pritet që të jenë në gjendje të operojnë në mënyrë efektive me armën si pjesë e pajisjes së tyre operative.

Përshkrimi i kursit:

Përmbajtja e modulit është dizajnuar për pjesëmarrësit si vijon:

- njohuria punuese e armës, origjina dhe karakteristikat e saja,
- çmontimi, pastrimi, montimi dhe kontrollimi i funksionimit të sistemit të armës,
- manipulimi me armë sipas standardeve të përshkruara ndërkombëtare të sigurisë,
- manipulimi me armë në mënyrë të sigurt dhe efektive në funksionin të cilin zyrtarët do ta kryejnë

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- zotërojnë shkathtësi në rastet e çmontimit dhe montimit të MP 5 dhe ta kontrollojnë sistemin e funksionimit të armës,
- dinë rëndësinë e mirëmbajtjes,
- manipulojnë me armën MP 5 nga distanca të afërta dhe të largëta si dhe të veprojnë me armën sipas përshkrimit të standardeve ndërkombëtare të sigurisë
- dinë të gjitha karakteristikat e armës MP-5
- zbatojnë dispozitat ligjore gjatë bastisjes së personave dhe kontrollimin e veturave me armën MP-5

3. Trajnimet e SHOP-it

Titulli i kursit: Përgjegjësi i parë emergjent

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Prestarët e policisë, doganës, korrektuesit dhe DME -ja |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e policisë, doganës, korrektuesit, DME |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Të rris shkathtësitë e pjesëmarrësve që ata të jenë në gjendje të intervenojnë shpejt dhe në mënyrë efikase në raste emergjente.

Përshkrimi i kursit:

Pjesëmarrësit trajnohen në mënyrë teorike dhe praktike për t'i avancuar shkathtësitë e dhënies së ndihmës së parë. Pjesëmarrësit testohen në fund të kursit.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- dinë rolin dhe detyrën e policit i cili arrin i pari në vendin e ngjarjes,
- ofrojnë ndihmën e përgjithshme mjekësore për personat e lënduar,
- zotërojnë shkathtësi për ngritjen, lëvizjen dhe bartjen e pacientëve në mënyrë të sigurt, për sigurinë e pacientit

Titulli i kursit: Ricertifikimi

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 3 ditë (21 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe doganierët |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe doganierët |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Gjatë kësaj periudhe 3 ditore pjesëmarrësve u rifreskohen njohurit që kanë të bëjnë me punën e tyre të përditshme dhe që i kanë mësuar më parë gjatë trajnimit themelor.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë kësaj periudhe 3 ditore pjesëmarrësit trajnohen në mënyrë teorike dhe praktike më qëllim të rifreskimit të njohurive që ata posedojnë.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- zotërojnë aftësi që të manipulojnë me mburojën si dhe përdorimin e shufrave të gjata në rastet të trazirave qytetare,
- përdorin taktikat e vetëpërmbajtjes gjatë ballafaqimit me personat agresiv,
- demonstrojnë shkathtësitë e tyre gjatë arrestimit dhe transportimit të personave të dyshimtë.

4. Trajnimet e specializuara

Titulli i kursit: Hetimi themelor i krimit

Kohëzgjatja: 4 javë (140 orë)

Kushtet paraprake: Pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët me sukses kanë përfunduar Kursin bazik të trajnimit, të caktuar në njësitet e hetuesisë.

Grupi i synuar: Policët e PK-së të cilët punojnë në fushën e hetuesisë.

Kontakti në QKSPEZH: Administrimi i kursit, Ext 271
E-mail: course-admin@kpss-ko.org

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit të suksesshëm të kursit pjesëtari i Policisë së Kosovës mund t'i marrë rolet e reja dhe përgjegjësitë më të mëdha në hetimin e rasteve të krimit.

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është i ndarë në 3 module dhe është i dizajnuar që t'i pajis policët e PK-së me njohuritë dhe shkathtësitë elementare për kryerjen e hetimeve të krimit.

Moduli i parë përmban udhëzimet në legjislacion në lidhje me lëmenjtë vijuese: Veprat penale kundër pasurisë, kundër jetës dhe trupit, kundër dinjitetit dhe moralit personal, kundër të drejtave dhe lirive të njerëzve dhe qytetarëve, krimet kundër rendit publik,

Moduli i Dytë përfshinë teknikat e intervistimit dhe është i dizajnuar që t'i pajis studentët me shkathtësitë e nevojshme për kryerjen e intervistimit me të dyshuarit, dëshmitarët ose viktimat, vetëdijesimin mbi forenzikën dhe menaxhimin e vendit të ngjarjes,

Moduli Tretë merret me procedurat penale me theks të veçantë në hetimin e veprës penale.

Gjithashtu, ekzistojnë ushtrimet praktike dhe shembujt për të ndihmuar studentin në kuptimin e mëtejshëm të lëndës. Gjatë tërë kursit ekzistojnë 3 kontrollime të njohurisë dhe testi final.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- njohin sistemin e së drejtës penale,
- njohin të drejtat e njeriut,
- bëjnë identifikimin e vjedhjes, vjedhjes së rëndë, shpërdorimin,
- bëjnë arrestimin dhe paraburgimin sipas procedurës ligjore,
- identifikojnë dëmtimin dhe shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm,
- dinë të bëjnë kallëzimin penal etj,

Titulli i kursit: Hetimi i avancuar i krimit

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 3 javë (105 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët me sukses kanë përfunduar Kursin bazik të hetimit, dhe të cilët pastaj kanë shërbyer më shumë se gjashtë (6) muaj në njësitin e hetuesisë |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e PK-së të cilët punojnë në fushën e hetuesisë |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi kursit:

Pas përfundimit të suksesshëm të kursit dhe të testit, pjesëtari i Policisë së Kosovës mund t'i marrë rolet e reja dhe përgjegjësitë më të mëdha në hetimin e rasteve të krimit

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është i dizajnuar që të rris kapacitetet e pjesëtarëve të PK-së të cilët e kanë mbaruar Kursin bazik të hetimit të krimit.

Kursi përfshinë trajnimin e avancuar në shkathtësitë e hetimeve të krimit si dhe temat të cilat nuk janë mbuluar në kursin bazik.

Ata të cilët e mbarojnë këtë kurs do të jenë në gjendje që t'i përgjigjen çdo pyetjeje dhe t'i ndihmojnë të tjerëve në këtë lëmi. Kursi është i dizajnuar që t'i pajis policët e PK-së me njohuri dhe shkathtësi të avancuara me qëllim të kryerjes së hetimeve të krimit.

Gjatë tërë kursit ekzistojnë 2 kontrollime të njohurisë dhe testi final.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kryejnë hetimet e krimit,
- njohin procedurën penale,
- identifikojnë dëshmitë fizike,
- bëjnë hetimin mbi zjarrvënie,
- bëjnë hetimin e korrupsionit si vepër penale
- bëjnë hetimet mbi vrasjen etj.

Titulli i kursit: **Kursi i specializuar i hetimeve**

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 5 javë (175 orë) |
| Kushtet paraprake: | Këtë kurs mund ta ndjekin pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët e kanë të kryer Kursin bazik të hetimeve dhe Kursin e avancuar të hetimeve |
| Grupi i synuar: | Vetëm pjesëtarët e Policisë së Kosovës |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që t'i njoftoi pjesëmarrësit me hetimin dhe metodikën e zbulimit të rasteve.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi do të përdoren metoda të ndryshme duke filluar nga vendi i ngjarjes, intervistimi i personave, mbledhja e dëshmive, deri te vëzhgimi i personave.

Në fund të kursit pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen dy testeve.

Të priturat nga ky kurs

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- njohin procesin e hetimeve penale, veçanërisht me rastet e drogës,
- bëjnë identifikimin e armës së përdorur në krim,
- kuptojnë vlerën e gjurmëve të gishtërinjve dhe rëndësinë që ato kanë në identifikimin e të dyshimitit.
- njohin elementet kyçe të lëndimeve fizike, faktorët rëndues dhe metodat e hetimeve të kësaj vepre kriminale,
- kuptojnë rëndësinë e raportit të hetimit rreth personit të zhdukur, shkathtësitë e nevojshme dhe njohurinë që kërkohet për ta zhvilluar një hetim të tillë, etj.

Titulli i kursit: Trafikimi me qenie njerëzore

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Prioritet kanë policët që punojnë në njësitin për trafikim me qenie njerëzore |
| Grupi i synuar: | Vetëm pjesëtarët e Policisë së Kosovës |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësit të njoftohen me ligjet dhe rregulloret që zbatohen në rastet me trafikim të qenieve njerëzore.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi do të trajtohen tema të ndryshme mësimore në lidhje me parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore duke madh parasysht mbrojtjen e të drejtave të njeriut në çdo aspekt.

Të priturat nga ky kurs

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- dinë çka është trafikimi me qenie njerëzore
- dinë qëllimin e trafikimit me qenie njerëzore
- dinë procesin e trafikimit me qenie njerëzore
- dinë kush është viktimë më e shpeshtë e trafikimit me qenie njerëzore
- njohin instrumentet ndërkombëtare dhe vendore kundër trafikimit me qenie njerëzore
- parandalojnë dhe luftojnë trafikimin më qenie njerëzore
- mbrojnë dhe ndihmojnë viktimat e trafikimit

Titulli i kursit: Delikuenca e të miturve

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Kursi bazik i hetimeve |
| Grupi i synuar: | Hetues policor për të mitur |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Studentët të jenë të njoftuar me njohuri themelore që kërkohen për të punuar me delikuencën e të miturve

Përshkrimi i kursit

Hetimi i delikuencës së të miturve, faktorët kriminal të delikuencës së të miturve në Kosovë, Procedura Penale, masat dhe dënimet, zyra ligjore, sjellja asociale dhe kriminale e fëmijëve dhe e të rinjve, delikuenca e të miturve (aspekti kriminal), procedura penale për të miturit, delikuenca e të miturve – roli i shërbimit korrektues, hetimi i delikuencës së të miturve

Të priturat nga ky kurs

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- bëjnë hetimin e delikuencës së të miturve sipas procedurës për kundërvajtje,
- identifikojnë delinkuentët e mitur si dhe ndikimin që ka aspekti social në delikuencë,
- Identifikojnë faktorët kriminogjen që ndikojnë në delikuencën e të miturve,
- njohin procedurën penale e cila zbatohet për të mitur,
- njohin të drejtat e të miturve gjatë procesit të procedurës penale etj.

Titulli i kursit: Hetimi i dhunës familjare

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët kanë kryer Trajnimin bazik dhe të cilët kanë së paku gjashtë muaj eksperiencë në zbatim të ligjit. |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës: Njësiti i dhunës familjare, Njësiti i Policisë në komunitet, Hetimet në terren dhe patrullimi. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit të suksesshëm të kursit të dhunës familjare, studenti do të jetë i njoftuar për fenomenin e dhunës familjare dhe do të ketë përfituar njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për identifikimin e abuzimit familjar dhe reagimin korrekt ndaj dhunës familjare.

Përshkrimi i kursit:

Programi i mësimet të kursit i adreson aspektet historike, sociale, ligjore dhe ato të zbatimit të ligjit të dhunës familjare. Kursi u jep pjesëmarrësve definicionin e qartë të dhunës familjare si dhe të ndikimit si në viktimën ashtu edhe në shoqëri.

Jepet një pasqyrë e perspektivës historike, sociale dhe ligjore të problemit si dhe ligjet specifike të vendit dhe metodat më të mira për adresimin e çështjeve për zbatuesit e ligjit.

Duke përdorur temën e zakonshme të mbrojtjes së viktimës dhe përfshirjes së komunitetit, kursi bën vështrimin e dinamikës psikologjike të dhunës familjare, sigurisë së viktimës, si dhe efektin e këtij problemi që ka në fëmijët dëshmitarë.

Ushtrimet praktike, duke përfshirë luajtjen e roleve dhe testin me shkrim, përforcohen me videot e trajnimit dhe këto përdoren për të demonstruar synimet e mësimet gjatë kursit.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë se çka është dhuna në familje,
- kush është viktimë më e shpeshtë e dhunës në familje,
- dinë rolin e tyre si polic në bashkësi lidhur me hetimin e dhunës në familje,
- identifikojnë shkaktuesin e mundshëm dhe dyshimin e arsyeshëm të dhunës në familje,
- dinë të reagojnë në incidente të shkaktuara nga dhuna në familje,
- dinë të bëjnë intervistimin e të dyshuarit, viktimës, dhe dëshmitarit.

Titulli i kursit: Hetimi i drogave

Kohëzgjatja: 2 javë (70 orë)

Kushtet paraprake: Pjesëtarët e PK-së të cilët kanë kryer me sukses Kursin bazik të hetimit të krimit dhe kanë njohuri të mëparshme mbi parandalimin e krimeve me droga, dhe të cilët punojnë në njësitin për hetimin e drogave.

Grupi i synuar: Pjesëtarët e PK-së të cilët punojnë në fushën e hetuesisë dhe të cilët në të ardhmen do të punojnë në fushën e hetimit të drogave.

Kontakti në QKSPEZH: Administrimi i kursit, Ext 271
E-mail: course-admin@kpss-ko.org

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit të suksesshëm të kursit dhe të testit, pjesëtari i Policisë së Kosovës mund t'i marrë rolet e reja dhe përgjegjësitë më të mëdha në hetimet, të bazuara në legjislacionin vijues.

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është i dizajnuar që t'i pajis studentët me shkathtësitë dhe njohuritë për t'i zbatuar metodat e ndryshme të hetimeve të krimit me droga, të bazuar në legjislacionin e aplikueshëm të Kosovës

Gjatë tërë kursit për çdo ditë ekzistojnë përsëritjet e mësimave si dhe testi final.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë se si ndikon keqpërdorimi i drogave në raportin familjar dhe shoqëror,
- dinë të bëjnë luftimin e kësaj dukurie negative sipas ligjit në fuqi,
- bëjnë arrestimin, kontrollimin, sekuestrimin me urdhëresë sipas procedurave dhe ligjeve të cilat janë në fuqi,
- bëjnë intervistimin e keqpërdoruesve të drogave në mënyrë profesionale,
- bëjnë identifikimin e llojeve të drogave duke përdorur metoda të ndryshme të testimit në teren.

Titulli i kursit: Kursi themelor për qendrat e mbajtjes

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të gjithë pjesëtarët e PK-së |
| Grupi i synuar: | Të gjithë pjesëtarët e PK-së të cilët punojnë në qendrat e mbajtjes (paraburgim). |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Ky kurs ka për qëllim t'i njoftoi pjesëmarrësit (policët) me ligjet dhe rregulloret që duhet të zbatohen në qendrat e paraburgimit.

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është i dizajnuar që t'i pajis studentët me shkathtësitë dhe njohuritë për t'i zbatuar rregullat dhe procedurat që janë të parapara në qendrat e paraburgimit.

Gjatë tërë kursit për çdo ditë ekzistojnë përsëritjet e mësimëve si dhe testi final.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- identifikojnë çrregullimet emocionale (shkaktarët që sjellin këtë gjendje), si dhe qasjen e gardianëve ndaj tyre,
- dinë qëllimin e marrjes së gjurmëve të gishtërinjve,
- dinë rregullat kryesore të fotografimit sinjalitik,
- të plotësojnë formularin mbi paraburgim sipas shpjegimit të bërë nga ana e inspektorit, e bazuar në formularët e Qendrës së Mbajtjes.

Titulli i kursit: Kursi i vëzhgimit

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët e kanë kryer Kursin bazik të trajnimit të policisë; që kanë patentë shoferi të vlefshëm dhe që janë zgjedhur për t'u bërë oficerë të vëzhgimit. |
| Grupi i synuar: | Oficerët e Policisë së Kosovës të cilët paraprakisht janë zgjedhur për t'u bërë anëtarë të njësitit të vëzhgimit. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit me sukses të kënaqshëm të trajnimit, oficeri i Policisë së Kosovës do të jetë në gjendje t'i kryej detyrat e vëzhgimit në mënyrë efektive dhe të shkathët.

Përshkrimi i kursit:

Përmbajtja e kursit është e dizajnuar që të trajnoj studentin në shkathtësi dhe njohuri të cilat janë të nevojshme për një anëtar profesional të Njësitit të vëzhgimit.

Trajnimi do t'i pajis oficerët e PK-së me shkathtësi dhe njohuri të nevojshme për kryerjen e vëzhgimit në këmbë dhe me automjet. Ditët e para janë teorike, pjesa e mbetur për kryerjen e pjesës praktike dhe në fund një skenar, duke i përdorur të gjitha shkathtësitë nga kursi.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë rëndësinë e shëndetit gjatë operacionit të vëzhgimit,
- njohin shërbimin e inteligjencës dhe funksionimin e saj,
- përpilojnë në mënyrë profesionale raportin e vëzhgimit,
- kuptojnë bazën ligjore që ka të bëjë me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit,
- njohin metodat dhe planifikimin e vëzhgimit.

Titulli i kursit: Kursi i analizave të inteligjencës

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët kanë kryer trajnimin bazik dhe të cilët janë zgjedhur në Njësitin e Inteligjencës. |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i Kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit me sukses të këtij moduli, pjesëtari i PK-së do të jetë në gjendje të kryej detyrat e inteligjencës siç janë mbledhja e informatave, shkruarja e raporteve të inteligjencës, kryerja e analizës dhe vlerësimin të inteligjencës.

Përshkrimi i kursit:

Përmbajtja e kursit është e dizajnuar për t'i trajnuar studentët në shkathtësitë dhe njohuritë të cilat kërkohen nga anëtari i Njësitit profesionist të Inteligjencës

Trajnimi do t'i jap pjesëtarëve të PK-së shkathtësitë e nevojshme për mbledhjen e informatave, shtruarjen e raportit të inteligjencës, analizimin dhe vlerësimin e inteligjencës dhe si të sillen me informatorët. Ata duhet ta kalojnë testin paraprak dhe testin final.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë çka është intelijenca,
- kuptojnë procesin e inteligjencës,
- bëjnë mbledhjen e informatave duke u mbështetur në burime të ndryshme,
- bëjnë vlerësimin e informatave,
- bëjnë analizimin e grupeve kriminale duke përdor metoda të ndryshme etj.

Titulli i kursit: Krim teknikët e vendit të ngjarjes

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 6 javë (210 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të kenë të kryer kursin bazik të hetimit; përparësi kanë pjesëtarë që punojnë në njësitin e forenzikës. |
| Grupi i synuar: | Vetëm pjesëtarët e Policisë së Kosovës |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësve t'ju ofroj njohuri rreth shikimit të vendit të ngjarjes, mbledhjes së provave dhe dëshmime fizike.

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është i dizajnuar që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri lidhur me shikimin dhe sigurimin e vendit të ngjarjes, marrjen e gjurmëve të gishtërinjve, mbledhjen e provave, përpilimin dhe menaxhimin e dosjes, etj.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- bëjnë shikimin dhe sigurimin e vendit të ngjarjes,
- bëjnë marrjen e gjurmëve të gishtërinjve,
- bëjnë mbledhjen e provave,
- bëjnë përpilimin dhe menaxhimin e dosjes, etj

Titulli i kursit: Përcjellja e personave me rrezikshmëri të lartë

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të jenë pjesëtarë të Policisë së Kosovës; përparësi kanë pjesëtarët e njësitit mbështetës operativ (NJMOR), si dhe Shërbimi Korrektues. |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe pjesëtarët e Shërbimit Korrektues |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri themelore sa i përket përcjelljes së personave me rrezikshmëri të lartë.

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është i dizajnuar në mënyrë që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri dhe shkathtësi mbi përcjelljen e personave me rrezikshmëri të lartë, duke përdorur lëvizje, teknika dhe taktika të ndryshme.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kenë efikasitet të lartë në gjuajtje me armë zjarri,
- demonstrojnë dhe të tregojnë rezultate shumë të mira në testet fizike si dhe në teknikat e taktikave mbrojtëse,
- demonstrojnë shkathtësi në ngasjen e veturave,
- demonstrojnë profesionalizëm të lartë, disiplinë gjatë përcjelljes së personave me rrezikshmëri të lartë etj.

III. Menaxhimi dhe mbikëqyrja

Titulli i kursit: Mbikëqyrja e vijës së parë

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 4 javë (140 orë) |
| Kushtet paraprake: | Ata të cilët e kanë kaluar me sukses vlerësimin për t'u bërë rreshter |
| Grupi i synuar: | Oficerët e Policisë së Kosovës do t'i nënshtrohen këtij kursi të obliguar për tu bërë mbikëqyrës i vijës së parë ose rreshter |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është t'u siguroj mbikëqyrësve të mundshëm policor njohuri themelore, shkathtësi dhe qëndrim që janë të nevojshme për funksionim si menaxherë policor në shoqërinë demokratike.

Përshkrimi i kursit:

Pas kryerjes me sukses të kënaqshëm të Kursit të mbikëqyrjes dhe kalimit të provimit final, rreshteri do të jetë në gjendje të merr role dhe përgjegjësi të mbikëqyrësit.

Pjesëmarrësit do të njoftohen me konceptet e mbikëqyrjes dhe do të mësojnë përgjegjësitë e mbikëqyrësit policor të vijës së parë, dhe për rolin e tyre në organizatën policore. Secili nga funksionet tradicionale të menaxhmentit policor siç është planifikimi, organizimi, koordinimi dhe raportimi i stafit, do të shqyrtohen në hollësi, në mënyrë që t'u ndihmohet pjesëmarrësve të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për t'u bërë mbikëqyrës efektiv.

Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet përgjegjësive të mbikëqyrësit në fushat e motivimit të punëtorëve, trajnimit, këshillimit dhe udhëzimit. Pjesëmarrësit gjithashtu do të njoftohen me vendimmarrjen dhe bashkëpunimin në zgjidhjen e problemit.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- bëjnë vlerësimin e tyre në mënyrë profesionale sa i përket vartësve të tyre,
- përdorin aftësitë e tyre komunikuese si mbikëqyrës,
- menaxhojnë punën si dhe mbikëqyrin stafin e tyre në mënyrë profesionale,
- dinë detyrat e përgjithshme lidhur me menaxhimin dhe lidhshipin,
- kuptojnë rëndësinë e motivimit në vendin e punës si vegël ose pikë referuese për mbikëqyrësin për të kuptuar nevojat e nëpunësve të vet,
- zbatojnë aftësitë motivuese dhe komunikuese në procesin e zgjidhjes së problemit.

Titulli i kursit: Menaxhimi i mesëm

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 8 javë (280 orë) |
| Kushtet paraprake: | Studenti duhet ta ketë kaluar me sukses Kursin e vijës së parë të mbikëqyrjes, të jetë i promovuar në rreshter dhe t'i ketë kaluar testet e vlerësimit për tu bërë toger |
| Grupi i synuar: | Rreshterët e mundshëm të PK-së të cilët janë në drejtim të promovimit në toger dhe kapiten |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i Kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është t'u siguroj mbikëqyrësve të mundshëm policor të nivelit të mesëm njohuri të nevojshme, shkathtësi dhe qëndrim në mënyrë që të funksionojnë si menaxherë policor në shoqërinë demokratike.

Përshkrimi i kursit:

Pas kryerjes me sukses të kënaqshëm të Kursit të menaxhimit të mesëm dhe kalimit të provimit final, dhe pas promovimit, studenti do të jetë në gjendje të merr role dhe përgjegjësi të togerit.

Pjesëmarrësit do të mësohen për konceptet e menaxhimit dhe do të njoftohen me përgjegjësitë e menaxhimit të mesëm policor, dhe për rolin e tyre në organizatën policore dhe në komunitet.

Kursi do të bazohet në mësimin maksimal ku studenti është kryesor dhe përfshihen studim rastesh, menaxhim të projekteve, raste reale, diskutime grupore. Puna grupore do të jetë një pjesë esenciale e kursit. Nga pjesëmarrësit pritet të vazhdojnë me punë grupore dhe mësim të pavarur çdo ditë pas përfundimit të orarit të caktuar.

Në javën e fundit të kursit pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen provimit në grupe dhe në mënyrë individuale në raportin e projektit me shkrim dhe në provimin me gojë.

Të priturat e këtij kursi

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të komunikimit ndër-personal në një organizatë bashkëkohore,
- bëjnë një vlerësim efektiv për mënyrën e kryerjes së punës (performancës),
- shtojnë njohurit dhe aftësitë e pjesëmarrësit rreth kuptimit të konfliktit që në mënyrë më efikase të menaxhojnë situatat konfliktuozë,
- njohin aspektin e planifikimit në nivelin e menaxherëve duke përfshirë konceptet, parimet dhe përpjekjet.

Titulli i kursit: **Sjellja me njerëz dhe shkathtësitë e punës në zyrë**

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëtarët nga të gjitha agjencitë për siguri publike në Kosovë, posaçërisht punëtorët e zyrave |
| Grupi i synuar: | Pjesëmarrës në këtë kurs mund të jenë pjesëtarët nga PK-ja, Dogana, Korrektuesit, DME-ja, stafi civil i policisë, etj. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit :

Qëllimi i këtij moduli është përmirësimi i efikasitetit të punës në zyrë.

Përshkrimi i kursit

Ky modul do të përqendrohet në teori duke iu shpjeguar pjesëmarrësve mënyrën se si duhet të komunikojnë gjatë orarit të punës. Theks i veçantë i kushtohet punës në zyrë dhe bashkëpunimit me të tjerët.

Pjesëmarrësit nuk do të testohen në fund të kursit.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë procesin e komunikimit dhe rëndësinë e tij brenda ekipit dhe organizatës,
- zbatojnë udhëzime dhe këshilla praktike lidhur me disa shkathtësi të rëndësishme të punës në zyrë të cilat duhet të aplikohen gjatë punës së përditshme,
- zbatojnë shkathtësi të mira raportuese,
- njohin aspektet e stresit, shkaktarët, mënyrat për menaxhimin e stresit si dhe ndikimin e stresit në individin dhe në një organizatë,
- zgjedhin problemet personale me menaxhimin e kohës duke implementuar shkathtësitë dhe teknikat e menaxhimit të kohës.

Titulli i kursit: **Analiza e nevojave të trajnimit**

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 3 ditë (21 orë) |
| Kushtet paraprake: | Policët duhet të kenë së paku 1 vit në shërbim. Pjesëmarrësit nga entitetet tjera të Sigurisë Publike do të selektohen sipas parimeve të agjencive të tyre |
| Grupi i synuar: | Ky modul është për trajnim të anëtarëve të të gjitha agjencive brenda QKSPEZH-it, por gjithashtu është edhe për agjencitë ose institucionet e jashtme publike. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit :

Qëllimi i këtij moduli është që t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri dhe shkathtësi të kryerjes së analizës së nevojave të trajnimit. Pas përfundimit me sukses të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të bëjnë analizën e nevojave të trajnimit në mënyrë të aftë.

Përshkrimi i kursit

Ky modul do të përqendrohet si vijon:

- rëndësia e analizës së nevojës së trajnimit;
- domethënia e termit “analiza e nevojave”;
- identifikimi i teknikave për hetimin e nevojave organizative dhe personale,
- identifikimi i llojeve të analizave të nevojave.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë se çka është analiza e nevojave,
- dinë llojet e analizave të nevojave,
- kuptojnë rëndësinë e analizës së nevojave të trajnimit,
- identifikojnë teknikat për hetimin e nevojave personale dhe organizative,
- analizojnë informatën dhe të shkruajnë raportin për analizën e nevojave.

Titulli i kursit: Menaxhimi i lartë

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 4 javë (140 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit në këtë kurs duhet të kenë kryer menaxhimin e mesëm. |
| Grupi i synuar: | Menaxherët e lartë nga PK-ja, Dogana, DME-ja, Shërbimi Korrektues. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit :

Qëllimi i këtij kursi është që të ngritet kapaciteti i pjesëmarrësve për menaxhim sa më efikas si, të burimeve njerëzore ashtu edhe atyre materiale, po ashtu bashkëpunimi i menaxherëve të lartë në mes veti për çështje madhore kur kemi të bëjmë me aspektin e sigurisë së Kosovës.

Përshkrimi i kursit

Ky kurs përmban pjesë teorike dhe praktike me skenarë të përshtatur për nivelin e pozitave që i kanë nëpër organizatat e tyre. Materiali mësimor fokusohet në fushat e menaxhimit dhe lidërshiptit, incidenteve madhore, të menduarit strategjik dhe alternativ, diversitetit etj.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- menaxhojnë me incidente të mëdha si eksplozimet, vërshimet, etj.
- menaxhojnë me burime njerëzore dhe ato materiale,
- krijojnë projekte dhe të menaxhojnë me to,
- mendojnë në mënyrë strategjike dhe alternative,
- menaxhojnë vlerësimin e rrezikut etj.

IV. Standardet e trajnimit

Titulli i kursit: Vetëdijesimi për të drejtat e njeriut

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët e PK-së të cilët e kanë kryer Kursin themelor të trajnimit |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e PK-së, Doganës, Shërbimit Korrektues dhe entitetet tjera të Sigurisë |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit të këtij kursi me sukses të kënaqshëm studenti do të ketë njohuri themelore për çështjet e të drejtave të njeriut.

Përshkrimi i kursit:

Qëllimi i kursit është që t'i përmirësoj njohuritë themelore të trajnerëve policor për të drejtat e njeriut.

Kursi është i orientuar në praktikë dhe në mënyrë specifike përqendrohet në çështjet e të drejtave të njeriut, siç janë: e drejta për jetë, demokracia, jo diskriminimi, e drejta për liri, ndalimi i torturës, liria e mbledhjes, liria e religjionit dhe shprehjes, çështjet gjinore, burimet e të drejtave të njeriut, etj. që kanë lidhje me aktivitetet e përditshme të zbatuesve të ligjit.

Secili pjesëmarrës që e ndjek këtë kurs duhet të kaloj testin me shkrim i cili i ka 20 pyetje (kalueshmëria është 70%). Përveç kësaj, ata duhet të tregojnë qëndrim pozitiv gjatë këtij kursi.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë cilat janë të drejtat e njeriut,
- dinë për mos-diskriminimin si element themelor i të drejtave të njeriut,
- dinë bazat themelore të së drejtës ndërkombëtare, marrëdhëniet e tyre me të drejtat vendore si dhe koncepti i përgjegjësisë shtetërore (në lidhje me rolin e zbatuesve të ligjit si agent shtetërorë),
- kuptojnë rëndësinë për mbrojtjen e së drejtës për jetë,
- kuptojnë nocionin e lirisë së lëvizjes, elementet themelore të lirisë së lëvizjes si një e drejtë e njeriut dhe disa situata kur e drejta e lirisë së lëvizjes kufizohet në baza ligjore.

Titulli i kursit: **Komunikimi jo-verbal dhe menaxhimi i stresit**

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 4 ditë (28 orë) |
| Kushtet paraprake: | Studenti duhet të ketë ose do të ketë rol aktiv në trajnim. Të jetë në gjendje të flasë dhe shkruaj në gjuhën shqipe dhe serbe në standarde të larta. |
| Grupi i synuar: | Stafi i OSBE-së, PK-së, Doganës, Shërbimit Korrektues dhe entiteteve tjera të Sigurisë Publike të cilët janë të përfshirë në trajnim. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësit të aftësohen me procesin e rregullt të komunikimit dhe metodave të tij

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs i njofton studentët me rëndësinë e komunikimit jo-verbal në klasë dhe efektin e tij në raportet instruktor-student.

Gjatë trajnimit 4 ditësh të pjesës teorike dhe praktike, lëndët dhe konceptet të cilat përfshihen janë: ndërtimi i grupit, komunikimi dhe metodat e komunikimit, komunikimi jo-verbal, deshifrimi i gjuhës së trupit dhe leximi i personave, historia kulturore dhe të miturit, qëndrimi dhe sjellja & kutia e betarit, dëgjimi efektiv, Stresi etj.

Kursi gjithashtu u ndihmon studentëve të identifikojnë stresin në vete dhe te të tjerët dhe u lejon atyre të shpikin strategji për tu marrë me stresin.

Për të qenë i suksesshëm në këtë kurs studenti duhet ta kaloj testin me përgjigje të shumëfishta i cili përbëhet prej 20 pyetjeve me 80 % të kalueshmërisë.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë procesin e rregullt të komunikimit dhe metodave të tij,
- dinë për komunikimin jo-verbal, llojet e komunikimit, dhe interpretimin e mesazheve jo-verbale,
- kuptojnë qëndrimin e gjuhës së trupit (gjestet trupore) dhe të jenë në gjendje ta deshifrojnë gjuhën e trupit,
- kuptojnë dallimet kulturore në përdorimin e komunikimit jo-verbal,
- kenë një këndvështrim lidhur me dëgjimin efektiv, etj.

Titulli i kursit: Barazia gjinore

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të jenë pjesëtarë të PK-së dhe agjencive tjera publike. |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarë të PK-së, si dhe të tjerët nga agjencitë tjera. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij mësimi është që pjesëmarrësit të njihen për së afërmi rreth përkufizimeve mbi baza gjinore dhe rreth rëndësisë së dy gjinive, si çështje thelbësore në shoqërinë demokratike.

Pjesëmarrësit duhet të dinë rëndësinë e integritit gjinor në shoqëri duke përfshirë specifikat, qëllimin, kulturën dhe traditat. Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit duhet të kenë njohuri rreth ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në Republikën e Kosovës sa i përket barazisë gjinore.

Përshkrimi i kursit:

Ky modul është i dizajnuar për t'i përgatitur pjesëmarrësit për natyrën e barazisë gjinore dhe rëndësinë e sajë në shoqërinë demokratike.

Pjesëmarrësit duhet të dinë rolin e rëndësishëm të grave në parandalimin, zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes. Po ashtu, duhet theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre të barabartë dhe përfshirjen e plotë në të gjitha përpjekjet për ruajtjen dhe çuarjen përpara të paqes dhe të sigurisë, si dhe për të rritur rolin e tyre në proceset vendimmarrëse, lidhur me parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit.

Për të qenë i suksesshëm në këtë kurs studenti duhet ta kaloj testin me përgjigje të shumëfishta i cili përbëhet prej 20 pyetjeve me 80% të kalueshmërisë.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- njihen rreth zhvillimit, përkufizimeve mbi barazinë gjinore dhe rreth rëndësisë së fuqisë së dy gjinive, si çështje thelbësore në shoqërinë demokratike,
- kuptojnë rëndësinë e analizës gjinore, si dhe pa-barazinë gjinore dhe ndikimet në familje dhe shoqëri,
- njohin shkaktarët e dhunës familjare, mitet reale në lidhje me rolet shoqërore të femrave dhe meshkujve që ushtrojnë dhunë të tillë, dhe t'i diskutojnë zgjidhjet e mundshme të këtij problemi që rrezikon jetët në një shoqëri, etj.

Titulli i kursit: Kursi për zhvillimin e instruktorëve

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 5 javë (175 orë) |
| Kushtet paraprake: | Policët duhet të kenë së paku 1 vit në shërbim. Pjesëmarrësit nga entitetet tjera të Sigurisë Publike do të selektohen sipas parimeve të agjencive të tyre . |
| Grupi i synuar: | Ky modul është për trajnim të oficerëve të PK-së, zyrtarë të doganës, zyrtarë korrektues, por gjithashtu mund të ketë pjesëmarrës nga agjencitë tjera publike, sipas kërkesës së tyre. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit. Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit të këtij kursi me sukses të kënaqshëm të tri pjesëve të modulit dhe kalimit të provimeve dhe prezantimeve të tri mësimeve, studenti do të jetë në gjendje të marr përsipër role dhe përgjegjësi të reja të trajnerit, projektimit të planit mësues me qëllimet dhe synimet e mësimit.

Përshkrimi i kursit

Programi për Trajnim të Instruktorëve është një program intensiv, i cili përbëhet prej tri pjesëve të cilat janë të dizajnuara për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të mësojnë teorinë dhe ta zbatojnë në praktikë.

Pjesëmarrësit mësojnë për teknikat e mësimit për të rritur, metodat e mësimit, shkathtësitë moderuese, planet trajnuese, qëllimet dhe synimet e trajnimit me shkrim, dizajnimin e mjeteve ndihmëse trajnuese efektive, menaxhimin i ambientit trajnues, trajtimin e situatave problematike, grupet, ndërtimin e grupeve, menaxhimin e konfliktit në grupe, shkaktarët e konfliktit, etj.

Të priturat e këtij kursi

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- njohin konfliktin dhe metodat që përdoren për të zgjidhur konfliktin, që është pjesë e përditshme e punës në përgjithësi,
- kuptojnë parimet e të mësuarit tek të rriturit,
- kuptojnë shkathtësitë drejtuese themelore të cilat janë të nevojshme për të gjithë instruktorët efektiv,
- kenë shkathtësinë e duhur për të hartuar dhe zbatuar qëllimin dhe synimet e trajnimit.
- kuptojnë rëndësinë e një plani të mësimit të përpiluar mirë dhe mënyrën e përpilimit të tij.

Titulli i kursit: Udhëheqësi i ekipit, ndërtimi i ekipit dhe menaxhimi i konfliktit

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Studenti duhet të ketë ose do të ketë rol aktiv në trajnim. Të jetë në gjendje të flasë dhe shkruaj në gjuhën shqipe dhe serbe në standarde të larta. |
| Grupi i synuar: | Stafi i OSBE-së, PK-së, Doganës, Shërbimit Korrektues, etj |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë e udhëheqësit të mirë, mënyrën e ndërtimit të ekipit të suksesshëm dhe menaxhimin e konfliktit.

Përshkrimi i kursit:

Të gjitha kurset e Udhëheqësit të ekipit, ndërtimit të ekipit dhe menaxhimit të konfliktit janë vendosur në një kurs.

Studentët mësojnë teorinë e udhëheqjes së mirë, si të zhvillojnë dhe motivojnë, karakteristikat e udhëheqjes, llojet e udhëheqësve, stilin e udhëheqësit, menaxhimin, vizionin, stërvitjen, trajnimin, ekipet, ndërtimin e ekipit, zhvillimin e grupit, menaxhimin e konfliktit, parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit.

Kjo vihet në praktikë përmes një numri të ushtrimeve të ndërtimit të ekipit.

Për të qenë i suksesshëm në këtë kurs studentit duhet ta kalojë testin me përgjigje të shumëfishta i cili përbëhet prej 15 pyetjeve me 80 % të kalueshmërisë.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- njoftohen me rolin dhe detyrat e udhëheqësit,
- dinë të definojnë karakteristikat e krijimit të ekipit të suksesshëm,
- merren me zgjidhjen e konfliktit në vendin e punës në mënyrë profesionale etj.

Titulli i kursit: Oficeri parësor i trajnimit fushor

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët e PK-së të cilët e kanë kryer kursin e OTF -së |
| Grupi i synuar: | Policia e Kosovës me përvojë e cila do të përfshihet në mësimin e rekrutëve të rinj pasi ata të diplomojnë në QKSPEZH |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit të këtij kursi me sukses të kënaqshëm, studenti do të jetë në gjendje të mësoj dhe trajnoj rekrutët e rinj në terren dhe të mbikëqyrë OTF-në.

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është i paraparë për të dhënë një përshkrim të përgjithshëm të pozitës së Oficerit Parësor të Trajnimit Fushor (OPTF). Oficeri parësor i trajnimit zakonisht punon nën direktivat e Komandantit të stacionit; pastaj, kur i kryen detyrat sipas këtij programi, ata iu përmbahen urdhrave dhe udhëzimeve të Koordinatorit të PK-së.

Oficeri Parësor i Trajnimit Fushor mund të ketë detyra të llojllojshme. Zakonisht, ai është përgjegjës për trajnim në stacion, duke përfshirë koordinimin me instruktorët tjerë të stacionit. Në përgjithësi, ai zhvillon trajnimin e OTF –së në klasë, në stacione për oficerët e posa diplomuar të PK-së. Përveç kësaj, nën udhëzimet e Koordinatorit të PK-së në nivel të stacionit, ai mund të mbikëqyr të gjitha format që janë parashtruar nga OTF.

Ky kurs i vlerëson studentët në fusha dhe shkathtësi të ndryshme, duke përfshirë dhënien e informatave kthyesë, analizave, trajnimit etj. Secili pjesëmarrës që e ndjek këtë kurs duhet të kaloj testin me shkrim i cili i ka 40 pyetje (kalueshmëria është 80%). Përveç kësaj, ata duhet të tregojnë qëndrim pozitiv gjatë këtij kursi.

Të priturat e këtij kursi

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- njoftohen me rolin e ekipit dhe udhëheqësit gjatë kryerjes së veprimeve të përditshme policore,
- njoftohen me dallimet në mes të të mësuarit të fëmijët dhe të rriturit dhe me format e ndryshme që duhet zbatuar në praktikë gjatë punës me kadetë,
- kuptojnë rëndësinë e planit të veprimit dhe zbatimin e tij në mënyrë që të zhvillohen aftësitë e kadetit,
- kuptojnë procesin e rregullt të komunikimit dhe metodave të tij,
- dinë për komunikimin jo-verbal, llojet e komunikimit, dhe interpretimin e mesazheve jo-verbale,

Titulli i kursit: **Oficeri i trajnimit fushor**

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Duhet të kenë të kryer kursin bazik të trajnimit. |
| Grupi i synuar: | Policia e Kosovës me përvojë e cila do të përfshihet në mbikëqyrjen e rekrutëve të rinj pasi ata të diplomojnë në QKSPEZH |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i Kursit:

Pas përfundimit të këtij kursi me sukses të kënaqshëm studenti do të jetë në gjendje t'i mësoj dhe trajnoj rekrutët e ri në terren.

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është i dizajnuar të zhvilloj aftësitë e oficerit për të trajnuar dhe zhvilluar rekrutët e rinj në terren. Oficeri i Trajnimit Fushor (OTF) zakonisht punon nën urdhrat e Komandantit të Stacionit, Koordinatorit të PK-së dhe Oficerit Parësor të Trajnimit Fushor. Roli i OFT është që të përkrahë dhe mbikëqyrë, ata duhet të udhëzojnë oficerët e PK-së të cilët kanë diplomuar në QKSPEZH (Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim), duke iu ndihmuar atyre të merren me situata të llojllojshme. Niveli i udhëzimit i cili kërkohet do të varet nga aftësia e oficerëve të posa diplomuar dhe nga natyra e incidentit.

OTF mund të ketë detyra të ndryshme, zakonisht ata janë përgjegjës për zhvillimin, vlerësimin, analizën, dhënien e informatave kthyesë, monitorimin, këshillimin etj. OTF luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e praktikantit dhe në marrjen e vendimit se a janë ata të gatshëm për të patrulluar në mënyrë të pavarur. Ky kurs do ti vlerësoj studentët në sfera dhe shkathtësi të ndryshme.

Secili oficer i PK-së që e ndjek këtë kurs duhet ta kaloj testin me shkrim që ka 50 pyetje (rezultati i kalueshmërisë 80 %). Përveç kësaj ata duhet të tregojnë qëndrim pozitiv gjatë këtij kursi.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njoftohen me rolin e ekipit dhe udhëheqësit gjatë kryerjes së veprimeve të përditshme policore,
- njoftohen me dallimet në mes të të mësuarit të fëmijët dhe të rriturit dhe format e ndryshme që duhet zbatuar në praktikë gjatë punës me kadetë,
- kuptojnë rëndësinë e planit të veprimit dhe zbatimin e tij në mënyrë që të zhvillohen aftësitë e kadetit,
- kuptojnë procesin e rregullt të komunikimit dhe metodave të tij.

V. Policia Kufitare

Titulli i kursit: Kursi themelor i Policisë Kufitare

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 5 javë (175 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët e Policisë së Kosovës të cilët e kanë kryer Kursin e trajnimit themelor. |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët janë të angazhuar në detyrat e Policisë së vijës kufitare, në njësitin e trafikimit dhe prostitucionit dhe në njësitin e komunikacionit |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësit të njoftohen dhe aftësohen lidhur me kryerjen e detyrave të Policisë Kufitare. Të dinë më shumë për aktivitetet brenda territorit të Shteteve të Schengenit. Të kenë njohuri themelore për Kodin Evropian të Etikës Policore sa i përket qëllimit dhe rolit të policisë në shoqërinë demokratike.

Përshkrimi i kursit:

Kursi është i dizajnuar për të përshkruar dhe të dinë për 'kufijtë e brendshëm' dhe 'kufijtë e jashtëm'. Përqendrimi kryesor i këtij kursi është bashkëpunimi dhe koordinimi në mes PK-së kufitare dhe Doganave të Kosovës. Kursi jep shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm për krimet me automjete në Evropë, për NIA, dhe strukturën e tij. Studentët mund të sqarojnë se si të kalkulojnë kontrollimin e shifrave duke përdorur standardet ICAO, zbulojnë MRZ të manipuluar për shkak të tipografisë së ndryshme duke u siguruar që ata janë të njoftuar me tipografinë standarde të ICAO-së.

Pjesëmarrësit e këtij kursi do t'i nënshtrohen tre lloje të testimeve (para-testit, testit të mesëm dhe testit final).

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- definojnë termet e menaxhimit të kufirit, kontrollimet kufitare, vëzhgimet kufitare, kufijtë tokësor, kufijtë ajror dhe kufijtë detar,
- fitojnë shkathtësi dhe aftësi të cilat janë të nevojshme për t'i kryer detyrat e tyre duke u bazuar në modelin e menaxhimit të kufijve të Bashkimit Evropian dhe rregullores së aplikueshme në Kosovë mbi lëvizjen e personave,
- dinë dispozitat ligjore që zbatohen në Kosovë lidhur me kalimin e paautorizuar të kufirit,
- dinë dokumentet e nevojshme të kërkuara për të kaluar një kufi shtetëror,
- identifikojnë numrin identifikues të automjetit; do të njohin të 17 shenjat e NIA-së, do të jenë në gjendje të gjejnë NIA-në, etiketën e NIA-së dhe NIA-të e dukshme,
- njohin masat e sigurisë kur polici kufitar ka të bëjë me kontrollimin e personave dhe automjeteve në pikën kufitare të kontrollimit etj.

Titulli i kursit: **Kursi i avancuar i Policisë së vijës kufitare**

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 3 javë (105 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët e Policisë së Kosovës të cilët e kanë kryer Kursin e trajnimit të vijës kufitare |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët e Policisë së Kosovës të cilët janë të angazhuar në detyrat e policisë së vijës kufitare, në njësitin e trafikimit dhe prostitucionit dhe në njësitin e komunikacionit |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Studentët janë në gjendje t'i zbatojnë mjetet praktike të drejtave të njeriut të cilat shfrytëzohen nga Policia e vijës kufitare dhe kufirit administrativ. Ata njoftohen me dispozitat themelore të Kodit Evropian të Etikës Policore në lidhje me qëllimin dhe rolin e policisë në shoqërinë demokratike, përgjegjësitë dhe të drejtat e policëve, dhe parimet e përgjithshme për veprimet/intervenimet policore. Pjesëmarrësit marrin përgjegjësitë e oficerit të parë në sigurimin, mbledhjen dhe trajtimin e dëshmisë materiale kritike që mund të gjendet drejtpërdrejt në vendin e ngjarjes së krimit serioz. Ata janë të njoftuar me procedurën ligjore për dhënien e autorizimit për të hyrë dhe qëndruar përkohësisht në Kosovë .

Përshkrimi i kursit:

Moduli ka të bëjë me dispozitat themelore të Kodit Evropian të Etikës Policore sa i përket qëllimit dhe rolit të policisë në shoqërinë demokratike, përgjegjësitë dhe të drejtat e policëve, parimet e përgjithshme për veprim/intervenim policor dhe sistemi i të drejtës penale Moduli gjithashtu ka të bëjë edhe me procedurat e policit të parë reagues që duhet të përmbahet kur bënë reagimin fillestar në vendin e ngjarjes, procedurat e përfshira në definimin dhe kontrollimin e kufijve ose sigurimin e perimetrit të vendit të ngjarjes, mbrojtja dhe sigurimi i vendit të ngjarjes, identifikimi i dëshmitëve, mbledhja e dëshmitëve, dokumentimi i dëshmitëve, etj.

Pjesëmarrësit gjatë tij kursi do të nënshtrohen para-testit dhe testit final.

Të priturat e këtij kursi:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- njohin dispozitat themelore të Kodit Evropian të Etikës Policore,
- informohen mbi të gjitha llojet e dokumenteve të rregullta dhe atyre të falsifikuara,
- njohin dhe identifikojnë llojet e karakteristikave të sigurisë (fibrat dhe planshet, fijet e sigurisë, ngjyrat reaguese, shenjat e ujit etj.) së dokumenteve të shteteve të Ballkanit, Evropës, SHBA e më gjerë.

Titulli i kursit: Kursi i specializuar i Policisë Kufitare

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të jenë zyrtarë të policisë kufitare të cilat janë të angazhuar si komandantë të pikave kufitare. |
| Grupi i synuar: | Komandantët e pikave kufitare të Policisë së Kosovës |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit në përgjithësi do të marrin njohuri që kanë të bëjnë me punën e Policisë Kufitare.

Përshkrimi i kursit:

Në këtë kurs pjesëmarrësit mësojnë për temat si: Menaxhimi i integruar i kufirit, Struktura e policisë kufitare, Ligjet e bashkimit evropian, Rregullorja e Dablnit, Menaxhimi i vendit të ngjarjes, Vëzhgimi i kufirit, Doracaku i Shengenit, Kodi Evropian i Etikës së policit etj.

Në fund të kursit pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit teorik.

Të priturat e këtij kursi

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- mësojnë lidhur me menaxhimin e integruar të kufirit,
- dinë strukturat e policisë kufitare,
- njoftohen me ligjet e bashkimit evropian,
- njoftohen me rregulloren e Dablnit,
- dinë të menaxhojnë vendin e ngjarjes,
- bëjnë vëzhgimin e kufirit etj.

Dogana e Kosovës

I. Trajnimet e avancuara

Titulli i kursit: Trajtimi i personave diplomatik

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 2 ditë (14 orë) |
| Kushtet paraprake: | Zyrtarët doganor të cilët ushtrojnë detyrën e kontrollit nëpër vendkalimet kufitare (degë doganore) |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët doganor / Degët doganore dhe Drejtoria e zbatimit të ligjit |
| Kontakti në QKSPEZH: | Spektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 <u>e-mail: trajnimi@dogana-ks.org</u> |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që zyrtarët doganor të njihen me procedurat dhe mënyrën e trajtimit të diplomatëve në kufi, bazuar në Konventën e Vjenës të vitit 1961 dhe Bazën Ligjore të funksionimit në Kosovë.

Përshkrimi i kursit:

Kursi është i dizajnuar në mënyrë që të siguroj se pjesëmarrësit kanë fituar njohuri mbi trajtimin e personave diplomatik në kufi, qëllimet dhe principet e Kartës së Kombeve të Bashkuara në lidhje me barazinë e sovranitetit dhe krijimin e marrëdhënieve diplomatike dhe të misioneve diplomatike në mes shteteve.

Kursi është i ndarë në 1 Modul ku zberthehen **tetë (8)** tema. Mësimet janë të dizajnuara që t'i pajisin pjesëmarrësit me njohuri të trajtimit të personave dhe mallrave diplomatike dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Në fund të kursit do të zbatohet testi final mbi njohuritë e përgjithshme.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë se çka janë diplomatët,
- zotërojnë njohuri lidhur me imunitetin (privilegjet) e diplomatëve,
- dinë bazën ligjore funksionale në Kosovë,
- dinë se si trajtohen diplomatët në kufi dhe çka cilësohet si incident diplomatik bazuar në aspektin doganor dhe procedurat në rastet e tilla.

Titulli i kursit: Trajnimi mbi TARIK-un. (Moduli I)

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të gjithë zyrtarët doganor prej gradës 5-7 të cilët nuk e kanë vijuar trajnimin. |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët doganor të DK-së |
| Kontakti në QKSPEZH: | Spektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 e-mail: trajnimi@dogana-ks.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllim i kursit është që oficerët dhe pjesëmarrësit tjerë të kuptojnë rëndësinë e klasifikimit të duhur dhe aplikimin e drejtë të rregullave të përgjithshme 1-6 për klasifikimin e mallrave të seksionit I, II, III dhe IV.

Përshkrimi i kursit:

Kursi është i dizajnuar në mënyrë që të siguroj se oficerët dhe pjesëmarrësit tjerë të jenë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e rregullave të përgjithshme që të kemi një aplikim dhe klasifikim uniformë në të gjitha pikat doganore,.Po ashtu të rriten njohurit lidhur me klasifikimin e mallrave në kapitujt 1-24, dhe të kuptojnë rëndësinë e klasifikimit të saktë për arsye se nga klasifikimet që bëhen nëpër pikat doganore nxirren edhe statistikat për udhëheqjen e politikës fiskale. Testi do të ketë 15 pyetje duke i përfshirë të gjitha njohuritë e përgjithshme mbi TARIK-un Moduli I-re

MODULI:

Moduli 1: Seksionet I,II,III,IV “Rregullat e përgjithshme të interpretimit; shënimet sqaruese të OBD- Kapitujt 1 deri 24 të TARIK-ut”

Në fund të kursit, studentët do të testohen në fusha (kapituj) të ndryshme në kuadër të testit final mbi njohuritë e përgjithshme.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë rëndësinë e klasifikimit të duhur dhe aplikimit të drejtë të rregullave të përgjithshme për klasifikimin e mallrave,
- zotërojnë shkathtësi lidhur me metodat të cilat përdorën për njohjen dhe klasifikimin e mallrave,

Titulli i kursit: Trajnimi mbi TARIK-un. (Moduli II)

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të gjithë zyrtarët doganor prej gradës 5-7 të cilët nuk e kanë vijuar trajnimin TARIK I (Moduli i I) |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët doganor të DK-së, zyrtarë të MBPZHR |
| Kontakti në QKSPEZH: | Sektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 <u>e-mail: trajnimi@dogana-ks.org</u> |

Qëllimi i kursit:

Qëllim i kursit është që oficerët dhe pjesëmarrësit tjerë të kuptojnë rëndësinë e klasifikimit të duhur dhe aplikimin e drejtë të rregullave të përgjithshme 1-6 për klasifikimin e mallrave të seksionit V,VI dhe seksioni XIII. Qëllim i kursit është klasifikimi uniformë dhe i duhur i mallrave të ndryshme, si dhe informimi nga këto seksione për materiet e rrezikshme toksike të cilat mundë të hasen gjatë punës së përditshme.

Përshkrimi i kursit:

Kursi është i dizajnuar në mënyrë që të siguroj se oficerët dhe pjesëmarrësit të informohen nga këto seksione për materiet e rrezikshme toksike. Të informohen me substancat e rrezikshme toksike sipas marrëveshjes së ADR. Të sqarohen lidhshmëritë mes kapitujve 28, 29 dhe kapitujve 30, 32, 38, si dhe lidhshmërinë mes kapitujve 25 dhe kapitujve 68, 69.

MODULI:

Moduli 2: **Seksionet V,VI** (kapitujt 25 dhe 38 dhe kapitujt 68 deri 69)

Në fund të kursit, studentët do të testohen në fusha (kapituj) të ndryshme në kuadër të testit final mbi njohuritë e përgjithshme.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë rëndësinë e klasifikimit të duhur dhe aplikimit të drejtë të rregullave të përgjithshme 1-6 për klasifikimin e mallrave,
- Informohen me substancat e rrezikshme toksike sipas marrëveshjes së ADR,
- zotërojnë shkathtësi lidhur me metodat të cilat përdorën për njohjen dhe klasifikimin e mallrave,

Titulli i kursit: Trajnimi “Procedurat doganore me ndikim ekonomik”

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët doganor nga të gjitha degët doganore dhe sektorët e DK-së të cilët nuk e kanë vijuar këtë trajnim. |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët doganor prej gradës 5 deri në gradën 7 |
| Kontakti në QKSPEZH: | Sektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 e-mail: trajnimi@dogana-ks.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që pjesëmarrësit të njoftohen me dispozitat e përgjithshme të procedurave doganore me ndikim ekonomik, qëllimi i përdorimit të tyre si dhe me bazën ligjore të funksionimit.

Përshkrimi i kursit:

Kursi është i ndarë në (6) module të cilat zbërthehen në njëzet e tre (23) tema.

Mësimet janë të dizajnuara që pjesëmarrësit të pajisen me njohuri mbi qëllimet e funksionimit të procedurave doganore me ndikim ekonomik, krijimin e lehtësirave tregtare duke ju mundësuar operatorëve ekonomik shtyrjen e afatit të pagesës së detyrimeve të mbuluara me garancinë bankare deri në momentin e lirimit të mallrave në qarkullim të lirë apo ri-eksportin e tyre.

Në fund të kursit do të zbatohet testi final mbi njohuritë e përgjithshme.

Të priturat nga ky kurs

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- zotërojnë njohuri lidhur me dispozitat e përgjithshme dhe njoftimet e përgjithshme mbi PDNE-në (procedurat doganore me ndikim ekonomik),
- njihen me procedurat e domosdoshme që duhet të zbatohen me qëllim të largimit të mallrave nga procedura e deponimit doganor,
- kenë njohuri rreth raporteve të pezullimit të detyrimeve, kamatës kompensuese dhe materialit ndihmës të prodhimit,
- dinë procedurën e përpunimit nën kontroll doganor, mënyrën e funksionimit, rolin dhe kushtet për autorizim.

Titulli i kursit: Trajnimi i specializuar për kontroll të automjeteve, bagazhit dhe pasagjerëve

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët doganor nga të gjitha degët doganore dhe sektorët e DK-së të cilët nuk e kanë vijuar këtë trajnim. |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët e DK-së |
| Kontakti në QKSPEZH: | Spektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 <u>e-mail: trajnimi@dogana-ks.org</u> |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që t'u ofroi zyrtarëve doganor njohuri të avancuara mbi kontrollin sistematik të automjeteve, bagazhit dhe pasagjerëve si dhe hapësirave të mundshme për fshehje dhe kontrabandë të mallrave.

Përshkrimi i kursit:

Kursi është i dizajnuar si udhëzues për zyrtarët doganor të cilët do të punojnë si zyrtar kontrollues në PKK. Secili zyrtar kontrollues duhet ta posedoj kuptimin themelor të kontrollit.

Edhe pse vendet e fshehjeve të mundshme janë të identifikuar, ato nuk janë tërësisht të njohura.

Për punën e mëtejshme të zyrtarëve kontrollues janë të nevojshme të dihet dhe identifikohet sistemi i kontrollit dhe metodat e kontrolleve të automjeteve, pasagjerëve, bagazhit, hapësirave.

Testi do të ketë 10 pyetje duke i përfshirë të gjitha njësitë mësimore. Testi do të jetë me mundësi të shumëfishta të përgjigjeve, nga të cilat vetëm një është e saktë

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë procedurat që aplikohen para dhe gjatë kontrollit sistematik të automjeteve,
- kenë njohuri lidhur me avantazhet dhe disavantazhet e qasjes sistematike të kontrollit,
- identifikojnë treguesit e mundshëm për ekzistimin e mallrave të kontrabanduara në bagazh,
- zbatojnë procedurat e sigurisë lidhur me kontrollimin e pasagjerëve.

Titulli i kursit: **Kontrolli i specializuar i autobusëve**

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Oficerët doganor t[cilët e kanë vijuar trajnimin me parë për kontrollin e automjeteve, bagazhit dhe pasagjerëve, |
| Grupi i synuar: | Oficerët doganor - përparësi kanë oficerët që ushtrojnë kontroll në vendkalimet kufitare dhe терминаlet doganore si dhe njësitet e anti-kontrabandës "FAST". |
| Kontakti në QKSPEZH: | Sektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 e-mail: trajnimi@dogana-ks.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që t'u ofroi zyrtarëve doganor njohuri të avancuara mbi kontrollin sistematik të autobusëve, pasagjerëve në atë autobus, bagazhit dhe hapësirave të mundshme për fshehje dhe kontrabandë të mallrave.

Zyrtarët e Doganës së Kosovës do të mësojnë në këtë mesim për ciklin, mënyrat dhe teknikat që zbatohen për një kontroll efikas dhe efektiv.

Përshkrimi i kursit:

Kursi është i dizajnuar si udhëzues për zyrtarët doganor, të cilët do të punojnë si zyrtar kontrollues në PKK. Secili zyrtar kontrollues duhet ta posedoj kuptimin themelor të kontrollit.

Edhe pse vendet e fshehjeve të mundshme janë të identifikuar, ato nuk janë tërësisht të njohura.

Sistemi i kontrollit dhe metodat e kontrolleve të autobusëve, pasagjerëve, bagazhit, hapësirave janë të nevojshme të dihen dhe identifikohen për punën e mëtejshme të zyrtarëve kontrollues.

Testi do të ketë 10 pyetje duke i përfshirë të gjitha njësitë mësimore. Testi do të jetë me mundësi të shumëfishta të përgjigjeve, nga të cilat vetëm një është e saktë

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- përdorin metoda të avancuara për kontrollimin e autobusëve, pasagjerëve, bagazhit, dhe hapësirave në autobus që mund të përdoren për kontrabandimin e mallit.
- përfitojnë njohuri të reja për ciklin, mënyrën dhe teknikat që zbatohen për një kontroll efikas dhe efektive.

Titulli i kursit: Komunikimi jo-verbal

Kohëzgjatja: 2 ditë (14 orë)

Kushtet paraprake: Trajnimi i dedikohet tërë stafit të doganës.

Grupi i synuar: Zyrtarët doganor të DK-së.

Kontakti ne QKSPEZH: Sektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215
e-mail: trajnimi@dogana-ks.org

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që t'u jap pjesëmarrësve një pasqyrë të përgjithshme të komunikimit jo-verbal, llojeve të komunikimit, dhe interpretimin e mesazheve jo-verbale.

Përshkrimi i kursit:

Mësimet janë të dizajnuara që t'i pajisin pjesëmarrësit me njohuri të nevojshme për kuptimin dhe deshifrimin e mundshëm të komunikimit jo-verbal, deshifrimin dhe leximin e gjuhës trupore, dallimet kulturore në përdorimin e komunikimit jo-verbal, qëndrimi, sjellja dhe kutia e Betarit si dhe dëgjimi efektiv.

Testi do të ketë 20 pyetje duke përfshirë të gjitha njësitet mësimore si dhe rolin dhe përgjegjësitë e oficerit doganor në zbatimin e drejtë të parimeve për të drejtat e njeriut.

Testi do të jetë me mundësi të shumëfishta (MCQ) të përgjigjeve, dhe pyetje për të cilat kërkohet përgjigje me shkrim.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë deshifrimin e mundshëm të komunikimit jo-verbal,
- dinë deshifrimin dhe leximin e gjuhës trupore,
- dinë dallimet kulturore në përdorimin e komunikimit jo-verbal,
- kuptojnë qëndrimin, sjelljen, dëgjimin dhe kutin e Bertarit.

Titulli i kursit: Të drejtat e njeriut

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 3 ditë (21 orë) |
| Kushtet paraprake: | Trajnimi i dedikohet tërë stafit të doganës. |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët doganor të DK-së. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Spektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 <u>e-mail: trajnimi@dogana-ks.org</u> |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është njoftimi i zyrtarëve doganor me nocionin “të drejtat e njeriut” dhe marrëdhëniet e të drejtave të njeriut me punën doganore, llojet e të drejtave të njeriut, historikun e zhvillimit të DNJ-ve, mënyrën e zbatimit, shkeljet e mundshme nga zyrtarët dhe format e sanksioneve.

Përshkrimi i kursit:

Mësimet janë të dizajnuara që t’ pajisin pjesëmarrësit me njohuri themelore për të drejtat e njeriut, dhe të rrisin vetëdijen për respektimin e të drejtave të tyre. Trajnimi parashihet të mbahet për tërë stafin e Doganës së Kosovës. Në fund të kursit do të zbatohet testi final si dhe pjesëmarrësit do të certifikohen.

Testi do të ketë 20 pyetje duke përfshirë të gjitha njësitet mësimore si dhe rolin dhe përgjegjësitë e oficerit doganor në zbatimin e drejtë të parimeve për të drejtat e njeriut.

Testi do të jetë me mundësi të shumëfishta (MCQ) të përgjigjeve, dhe me pyetje për të cilat kërkohet përgjigje me shkrim.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- pajisen me njohuri themelore për të drejtat e njeriut,
- rrisin vetëdijen për respektimin e të drejtave të njeriut.
- njoftohen me rolin e organeve të zbatimit të ligjit si përfaqësues të shtetit, të cilët i zbatojnë në mënyrë të paanshme ligjet, kodet dhe rregulloret e përpiluara në mënyrë demokratike.

Titulli i kursit: Trajnimi i specializuar për kontroll të aeroplanëve

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Zyrtarët doganor të cilët e kanë vijuar trajnimin me parë për kontrollin e ABP, kontrollin e autobusëve dhe kamionëve, rimorkiove dhe autoboteve, dhe kontrollit të mjeteve transportuese përmes hekurudhës. |
| Grupi i synuar: | Të gjithë zyrtarët doganor, veçanërisht zyrtarët që punojnë në Degën Doganore të Aeroportit si dhe njësitet e anti-kontrabandës "FAST" |
| Kontakti në QKSPEZH: | Spektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 e-mail: trajnimi@dogana-ks.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që t'u ofroj zyrtarëve doganor njohuri të avancuara mbi kontrollin sistematik të aeroplanëve. Zyrtarët e DK-së do të mësojnë në këtë trajnim për ciklin, mënyrat dhe teknikat që zbatohen për një kontroll efikas dhe efektiv.

Përshkrimi i kursit:

Trajnimi është i dizajnuara si udhëzues për zyrtarët doganor të DK-së, të cilët do të punojnë si zyrtar kontrollues. Secili zyrtar kontrollues duhet ta posedoj kuptimin themelor të kontrollit. Edhe pse vendet e fshehjeve të mundshme janë të identifikuar, ato nuk janë tërësisht të njohura. Sistemi i kontrollit dhe metodat e kontrolleve të aeroplanëve janë të nevojshme të dihen dhe identifikohen për punën e mëtejshme të zyrtarëve kontrollues-ekzaminues.

Testi do të ketë 10 pyetje duke i përfshirë të gjitha njësitë mësimore.

Testi do të jetë me mundësi të shumëfishta të përgjigjeve, nga të cilat vetëm një është e saktë

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- pajisen me njohuri të avancuara për kontrollimin specializuar për aeroplan, për pasagjerë të aeroplanëve, për bagazhe,
- përfitojnë njohuri të reja për ciklin, mënyrën dhe teknikat që zbatohen për një kontroll efikas dhe efektiv.

Titulli i kursit: Trajnimi i specializuar për kontroll të kamionëve, maunave, rimorkiove, dhe autoboteve

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Zyrtarët doganor të cilët e kanë vijuar trajnimin më parë për kontrollin e ABP dhe autobusëve. |
| Grupi i synuar: | Të gjithë zyrtarët doganor; përparësi kanë zyrtarët që ushtrojnë kontroll në vendkalimet kufitare dhe terminalët doganorë si dhe njësitet e anti-kontrabandës "FAST". |
| Kontakti në QKSPEZH: | Sektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 e-mail: trajnimi@dogana-ks.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që t'u ofroj zyrtarëve doganor njohuri të avancuara mbi kontrollin sistematik të kamionëve, maunave, rimorkiove, autoboteve si dhe procesin e plombimit. Zyrtarët e DK-së do të mësojnë në këtë trajnim për ciklin, mënyrat dhe teknikat që zbatohen për një kontroll efikas dhe efektiv.

Përshkrimi i kursit:

Trajnimi është i dizajnuara si udhëzues për zyrtarët doganor, të cilët do të punojnë si zyrtar kontrollues në PKK. Secili zyrtar kontrollues duhet ta posedoj kuptimin themelor të kontrollit. Edhe pse vendet e fshehjeve të mundshme janë të identifikuar, ato nuk janë tërësisht të njohura. Sistemi i kontrollit dhe metodat e kontrolleve të autoboteve, maunave, rimorkiove, kontejnerëve dhe sistemi i plombimit janë të nevojshme të dihen dhe identifikohen për punën e mëtejshme të zyrtarëve kontrollues-ekzaminues.

Testi do të ketë 10 pyetje duke i përfshirë të gjitha njësitë mësimore.

Testi do të jetë me mundësi të shumëfishta të përgjigjeve, nga të cilat vetëm një është e saktë.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- pajisen me njohuri të avancuara për kontrollimin e specializuar të kamionëve, maunave, autoboteve, rimorkiove, si dhe me procesin e plombimit.
- përfitojnë njohuri të reja për ciklin, mënyrën dhe teknikat që zbatohen për një kontroll efikas dhe efektive.

Titulli i kursit: Trajnimi themelor për “Arrest dhe ndalim”

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të jenë zyrtarët doganor nga Drejtoria e zbatimit të ligjit. |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët doganor / Drejtoria e zbatimit të ligjit. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Spektori i trajnimeve, zyra në QKSPEZH ext.215 e-mail: trajnimi@dogana-ks.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është që zyrtarët doganor të mësojnë teknikat dhe taktikat si dhe zhvillimin e aftësive të kërkuara gjatë zbatimit të detyrave të tyre në terren.

Përshkrimi i kursit:

Trajnimi mbështetet në zhvillimin e aftësive të kërkuara të zyrtarëve të rinj të Zbatimit të Ligjit në zbatimin e detyrave operative. Trajnimi është i ndarë në pjesën teorike dhe praktike që përfshinë: Taktikat Mbrojtëse, Rregullat dhe procedurat e përdorimit të forcës, Ndhmën e Parë dhe të Drejtat e Njeriut. Trajnimi është i ndarë në 1 Modul të cilat zbërthehen **tetë (8)** tema.

Për të përmbushur me sukses trajnimin zyrtarët doganor i nënshtrohen testeve, përfshirë testin teorik dhe atë fizik

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- pajisen me njohuri themelore mbi rregullat dhe procedurën e prangimit/arrestit,
- dinë t'i respektojnë të drejtat e njeriut,
- ofrojnë ndihmën e parë.

Departamenti i menaxhimit të emergjencave - DME

I. Trajnimi themelor për zjarrfikje dhe shpëtim

Titulli i kursit: Zjarrfikja dhe shpëtimi – kursi themelor 2 javor

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 2 javë (70 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të jetë pjesëmarrës aktiv i SHZSH, të ketë shkollën e mesme, shkathtësi psikofizike, të ketë të kryer trajnimin bazik të zjarrfikësve dhe shpëtimit |
| Grupi i synuar: | Aplikuesë të suksesshëm të Shërbimit të Brigadës së Zjarrfikjes |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Përshkrimi i kursit:

Qëllimi i këtij moduli është që zjarrfikësit në fund të kursit të dinë se si t'i përdorin pajisjet kundër zjarrit, pajisjet për fikjen e zjarrit, evakuimin emergjent dhe dhënien e ndihmës së parë.

Përshkrimi i kursit:

Përmbajtja e këtij moduli është mbi mënyrën e fikjes së zjarrit. Për shkak të llojllojshmërisë së pajisjeve të teknologjisë dhe automjeteve të cilat përdoren tani dhe në të ardhmen, ata nuk mund t'i komentojnë të gjitha sistemet të cilat përherë janë duke u ndryshuar. Për këtë arsye, studentët gjithmonë do të pajisen me informata të reja për teknologjinë e re. Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do të marrin njohuri dhe shkathtësi fillestare për zjarrfikje dhe shpëtim, dhe në të ardhmen zjarrfikësit do të jenë në gjendje t'i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e punës si zjarrfikës fillestar në Shërbimin e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kenë qëndrim, dituri, aftësi dhe të jenë të përgatitur fizikisht,
- dinë llojet e evakuimeve emergjente në mënyrë profesionale nga vendet e ndryshme,
- dinë fazat e përgatitjes së intervenimit në rastet e lajmërimit të ndonjë rreziku potencial,
- zotërojnë shkathtësi në përdorimin e aparatit të frymëmarrjes dhe të dinë rastet kur duhet të përdoret, si dhe rreziqet që parashihen gjatë përdorimit të tij,
- zbatojnë procedurat e përdorimit të fikëses gjatë shuarjes së zjarrit - metoda T'D'SH'L,
- identifikojnë dallimin në mes "Flashover" dhe "Beckdraft.

Titulli i kursit: Zjarrfikja dhe shpëtimi – kursi themelor 5 javor

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 5 javë (157 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të gjithë pjesëmarrësit të cilët punojnë nëpër SH.Z.SH duhet ta kenë të kryer këtë kurs për të vazhduar me trajnimet të tjera. |
| Grupi i synuar: | Në këtë trajnim marrin pjesë pjesëtarët e Shërbimeve të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, pjesëtarët e Shërbimit Korrektues, pjesëtarët e KEK-ut të cilët e ushtrojnë këtë detyrë në organizatën e tyre. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Përshkrimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit të fitojnë shkathtësi, dhe njohuri të nevojshme që të kenë mundësi të merren me sukses me përdorimin e pajisjeve zjarrfikëse, shuarjen e zjarreve si dhe shpëtimin e njerëzve, pronës dhe natyrës. Gjatë shuarjes së zjarreve në mënyrë të sigurt dhe efikase duke përdorur njohurit dhe teknikat e mundshme si në intervenime, mënyrat e evakuimeve si dhe mënyrat më efikase të dhënies së ndihmës së parë etj.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do të aftësohen në përdorimin e pajisjeve personale dhe të përbashkëta, me mënyrat e intervenimeve dhe evakuimeve të ndryshme, me mënyrat profesionale të përdorimit dhe menaxhimit të aparatit të frymëmarrjes, me lloje të ndryshme të përdorimit të kamionëve zjarrfikës, me procesin e lindjes zhvillimit dhe me mënyrën profesionale të shuarjes së zjarrit duke ia përshtatur materien adekuate lëndës djegëse dhe dhënien e ndihmës së parë.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë t'i përdorin pajisjet zjarrfikëse personale dhe të përbashkëta,
- bëjnë intervenime,
- bëjnë furnizimin me ujë,
- dinë të përdorin automjetet zjarrfikëse,
- njohin teorinë themelore të zjarrit,
- dinë të bëjnë evakuime emergjente,
- dinë të përdorin aparatet e frymëmarrjes,
- dinë t'i përdorin aparatet për shuarjen e zjarrit
- dinë t'i përdorin shkallët
- intervenojnë në zjarret e brendshme
- bëjnë përpilimin e planeve operative
- dinë të japin ndihmën e parë etj.

II. Trajnimet e avancuara

Titulli i kursit: Shërbimet e zjarrfikjes dhe shpëtimit – kursi profesional

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 8 javë (280 orë) |
| Kushtet paraprake: | Të jetë pjesëmarrës aktiv i SHZSH, të ketë shkollën e mesme, shkathtësi psikofizike, të ketë të kryer trajnimin bazik të zjarrfikësve dhe shpëtimit |
| Grupi i synuar: | Zyrtarët e Shërbimit të Brigadës së Zjarrfikjes |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij moduli është që zjarrfikësit në fund të kursit të dinë mënyrën, taktikat dhe teknikat duke i përdorur dhe manipuluar me pajisjet e zjarrfikjes dhe dhënies së ndihmës së parë

Përshkrimi i kursit:

Duke i ndjekur të gjitha modulet e sipërpërmendura, zjarrfikësit do të dinë mënyrën korrekte të përdorimit të pajisjeve për zjarrfikje dhe do të jenë në gjendje të japin ndihmën e parë në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Ky modul i pajisë pjesëmarrësit me njohuri dhe shkathtësi në fushën e pajisjeve të zjarrfikjes dhe të ndihmës së parë. Zjarrfikësit në të ardhmen do të jenë në gjendje t'i kryejnë dhe ti ndërmarrin përgjegjësitë e punës, duke i aplikuar shkathtësitë dhe njohurinë që e kanë mësuar gjatë këtij trajnimit.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë procedurat e mundshme të evakuimit të personave në rastet emergjente në mënyrë profesionale nga vendet e ndryshme,
- dinë rëndësinë që kanë mjetet e thjeshta për shuarjen e zjarrit, roli dhe rëndësia e tyre gjatë shuarjes së zjarreve në rastet emergjente,
- zotërojnë aftësi psikike edhe fizike.

Titulli i kursit: Kursi i ndihmës së parë i specializuar në sistemin e reagimit emergjent

Kohëzgjatja: 1 javë (35 orë)

Kushtet paraprake: Pjesëmarrësit duhet ta kenë të kryer kursin themelor të ndihmës së parë.

Grupi i synuar: Zyrtarët e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, doganierët, shërbyesit korrektues të cilët e ushtrojnë detyrën e tyre nëpër shërbimet përkatëse

Kontakti në QKSPEZH: Administrimi i kursit, Ext 271
E-mail: course-admin@kpss-ko.org

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit të mësojnë njohuritë e nevojshme për t'u mundësuar që të ballafaqohen me sukses në dhënien e ndihmës së parë në raste emergjente në mënyrë të sigurt dhe profesionale, efikase duke përdorur njohuritë dhe teknikat e mundshme në situata të ndryshme.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do të bëjnë rifreskimin e njohurive mbi ndihmën e parë, përdorimin e pajisjeve nga çanta e ndihmës së parë, përdorimin e pajisjeve që nuk gjenden në çantën e ndihmës së parë.

Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit teorik dhe praktik.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë ta bëjnë sigurimin e vendit të ngjarjes në situatat emergjente si dhe pas procesit tre hapësh (a,b,c),
- dinë ta bëjnë përdorimin e pajisjeve nga çanta e ndihmës së parë,
- dinë ta bëjnë përdorimin e pajisjeve që nuk gjenden në çantën e ndihmës së parë.

Titulli i kursit: Zjarret e brendshme

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 1 javë (35 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit duhet ta kenë të kryer Kursin Bazik të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, si dhe Kursin e Avancuar të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit. |
| Grupi i synuar: | Në këtë trajnim duhet të marrin pjesë vetëm pjesëtarët e Shërbimeve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (SHZSH) të cilët e ushtrojnë detyrën e zjarrfikjes dhe shpëtimit nëpër shërbimet e tyre |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit të mësojnë shkathtësitë dhe të pajisen me dituri të nevojshme për tu ballafaquar dhe të merren me sukses me zjarret e brendshme në mënyrë të sigurt dhe efikase duke përdorur njohurit dhe teknikat e mundshme, pasi që rreziku më i madh i zjarrfikësve kanoset në hyrjet në zjarret e brendshme.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do të mësojnë për pajisjet zjarrfikëse, teorinë themelore të zjarrit, furnizimin me ujë, aparatën e frymëmarrjes, evakuimet emergjente, ventilimin, pushkën impulsive, zjarret në dhomëza.

Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit teorik dhe praktik.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë ta kuptojnë lindjen, zhvillimin e zjarrit si dhe cilët janë elementet themelore të zjarrit,
- dinë mënyrat e furnizimit me ujë,
- dinë mënyrat e përdorimit të aparateve të frymëmarrjes dhe menaxhimin,
- dinë mënyrat e evakuimeve emergjente,
- dinë mënyrat e ventilimit,
- dinë ta përdorin pushkën impulsive,
- të kuptojnë zhvillimin e zjarrit në dhomëza.

Titulli i kursit: Aksidentet e komunikacionit rrugor

Kohëzgjatja: 1 javë (35 orë)

Kushtet paraprake: Pjesëmarrësit duhet ta kenë të kryer Kursin Bazik të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, si dhe Kursin e Avancuar të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, si dhe Kursin e Ndhmës së Parë.

Grupi i synuar: Në këtë trajnim duhet të marrin pjesë vetëm pjesëtarët e Shërbimeve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit të cilët e ushtrojnë detyrën e zjarrfikjes dhe shpëtimit nëpër shërbimet e tyre

Kontakti në QKSPEZH: Administrimi i kursit, Ext 271
E-mail: course-admin@kpss-ko.org

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij kursi është për t'i pajisur pjesëmarrësit me shkathtësitë dhe dijenitë e nevojshme në mënyrë që të ballafaqohen me sukses në aksidentet e komunikacionit rrugor (AKRR) në mënyrë të sigurt dhe efikase.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do të mësojnë se si të reagojnë me efikasitet në këso lloj situatash emergjente duke përdorur shkathtësitë si dhe teknikat e mësuara në tema të ndryshme që përfshihen brenda këtij kursi si: lëndimet e ndërlydhura me AKRR-në, procedurat e përgjithshme të AKRR-së, teknikat e shpëtimit, pajisjet hidraulike të shpëtimit, qasjen e ekipit, etj.

Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit teorik dhe praktik.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë disa nga mënyrat e lëndimeve të cilat shkaktohen nga aksidentet e komunikacionit,
- dinë mënyrën e rregullt të qasjes së ekipit në vendin e ngjarjes,
- dinë mënyrën e stabilizimit të automjetit si dhe menaxhimin e qelqit,
- dinë të bëjnë evakuimet emergjente, etj.

Titulli i kursit: Përdorimi i mjeteve themelore për shuarjen e zjarrit

Kohëzgjatja: 3 ditë (21 orë)

Kushtet paraprake: Pjesëmarrësit duhet ta kenë të kryer shkollën e mesme.

Grupi i synuar: Në këtë trajnim duhet të marrin pjesë vetëm pjesëtarët e Shërbimeve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit të cilët e ushtrojnë detyrën e zjarrfikjes dhe shpëtimit nëpër shërbimet e tyre, si dhe pjesëtarët e objekteve administrative.

Kontakti ne QKSPEZH: Administrimi i kursit, Ext 271
E-mail: course-admin@kpss-ko.org

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit të fitojnë shkathhtësitë dhe njohuritë e nevojshme për tu ballafaquar me sukses në përdorimin e mjeteve themelore gjatë shuarjes së zjarreve fillestare në mënyrë të sigurt dhe efikase duke përdorur njohuritë dhe teknikat e mundshme, gjatë përdorimit të hidrantëve, lindjen dhe shuarjen e zjarrit, mënyrat e evakuimeve dhe përdorimin e fikseve.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do mësojnë se si t'i përdorin mjetet themelore në shuarjen e zjarreve duke përdorur teknikat e ndryshme të cilat i mësojnë gjatë procesit mësimor. Pra, pjesëmarrësit do të aftësohen në shuarjen e zjarreve fillestare në mënyrë të sigurt dhe efikase.

Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit teorik dhe praktik.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë t'i përdorin pajisjet personale të zjarrfikëjes dhe shpëtimit,
- dinë mënyrat e furnizimit me ujë si dhe përdorimin e hidrantit të brendshëm dhe të jashtëm,
- kuptojnë lindjen, zhvillimin e zjarrit si dhe cilët janë elementet themelore të zjarrit,
- dinë ta bëjnë evakuimin emergjent,
- dinë ta bëjnë përdorimin e të gjitha llojeve të aparateve kundër zjarrit.

Titulli i kursit: Njohja dhe përdorimi i aparateve për orientim dhe ndihmë në natyrë (rrjeti GPS)

Kohëzgjatja: 2 ditë (14 orë)

Kushtet paraprake: Pjesëmarrësit duhet ta kenë të kryer më së paku shkollën e mesme.

Grupi i synuar: Në këtë trajnim duhet të marrin pjesë vetëm pjesëtarët e Shërbimeve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit të cilët e ushtrojnë detyrën e zjarrfikjes dhe shpëtimit nëpër shërbimet e tyre, si dhe zyrtarët e DME-së.

Kontakti në QKSPEZH: Administrimi i kursit, Ext 271
E-mail: course-admin@kpss-ko.org

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij mësimi është që pjesëmarrësit të njohohen me nocionet themelore të përdorimit të rrjetit të GPS, si dhe mundësitë që ofron rrjeti për orientimin në natyrë me përdorimin e aparateve të ndryshme marrëse.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do mësojnë se si të përdorin rrjetin GPS. Po ashtu, do të mësohen të orientohen në natyrë duke përdorur aparate të ndryshme marrëse.

Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit praktik.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë funksionimin dhe përdorimin e rrjetit të GPS,
- dinë të përdorin sistemin e navigatorëve personal eTrex,
- dinë t'i përdorin matësit mobil të kohës KESTRELL,
- jenë të pavarur në përdorimin e navigatorëve personal GPS në terren,
- bëjnë evakuimin emergjent.

Titulli i kursit: Inspektorët e mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësive natyrore si dhe fatkeqësive tjera

Kohëzgjatja: 2 javë (70 orë)

Kushtet paraprake: Pjesëmarrësit duhet të kenë kontratë pune për kryerjen e detyrës së inspektorit.

Grupi i synuar: Në këtë trajnim duhet të marrin pjesë inspektorët e mbrojtjes nga zjarri, të fatkeqësive natyrore dhe zyrtarët e planifikimit emergjent të nivelit qeveritar dhe atyre komunal të cilët ushtrojnë këto detyra në drejtoritë, gjegjësisht në departamentet e tyre sipas kontratës së punës.

Kontakti në QKSPEZH: Administrimi i kursit, Ext 271
E-mail: course-admin@kps-kp.org

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij mësimi është që njësitet të ngrisin aftësinë e veprimit të shpejtë dhe të efektshëm, në raste të paraqitjes së ndonjë fatkeqësie, me ç' rast kërkohet një reagim emergjent i shpejt i inspektorëve, zyrtarëve dhe njësiteve.

Ky kurs po ashtu forcon koordinimin mes strukturave emergjente, gjatë reagimit emergjent në përputhje me misionin. Përmes këtij kursi do të përcaktohet forma e involvimit dhe koordinimit të veprimeve gjatë të gjitha fazave të menaxhimit në parandalim, lehtësim, gatishmëri, reagim, rimëkëmbje dhe zhvillim.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do mësojnë për rifreskimin e njohurive të inspektimeve të objekteve të llojllojshme sipas rrezikshmërisë, në hartimin e procesverbalit dhe shqiptimin e gjobave.

Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të

- bëjnë kontrollimin e objekteve të lëmive të ndryshme sipas rrezikshmërisë,
- hartojnë procesverbalin pas çdo inspektimi,
- dinë të bëjnë vlerësimin e dokumentacionit në lidhje me dhënien e pëlqimeve në dokumentacion dhe në lokacion,
- dinë të procedojnë lëndën në gjykatë.

Titulli i kursit: Zjarret fushore – malore

| | |
|-----------------------------|--|
| Kohëzgjatja: | 3 ditë (21 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit e SH.Z.SH të Kosovës që e kanë të kryer kursin themelor. |
| Grupi i synuar: | Pjesëtarët e Shërbimeve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (SH.Z.SH) dhe shërbimet vullnetare. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që të fitojnë njohuri lidhur me zbulimin dhe pikënisjen e zjarrit me kohë, zbulimin e faktorëve kryesor të këtyre zjarreve, identifikimin e zanafillës së zjarrit fushor dhe malor, procesin e ndezjes të zhvillimit të zjarreve fushore dhe malore dhe njëherazi mënyrën e shuarjes së tij.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do mësojnë për pajisjet e luftimit të zjarreve fushore-malore, mënyrat e parandalimit të zhvillimit të zjarreve fushore-malore dhe procesin e ndezjes së zjarreve dhe djegies së fushave dhe maleve.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- merren me parandalimin e përhapjes së zjarrit fushor dhe malor,
- dinë procesin e ndezjes së zjarreve dhe djegies së fushave dhe maleve.

Titulli i kursit: Shuarja e zjarreve në objektet e larta

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 4 ditë (28 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit e SH.Z.SH të Kosovës që e kanë të kryer kursin themelor. |
| Grupi i synuar: | Vetëm pjesëtarët e Shërbimeve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (SH.Z.SH) të cilët e ushtrojnë detyrën e zjarrfikjes dhe shpëtimit dhe i kanë të përfunduar kurset paraprake themelore nëpër shërbimet e tyre. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit të mësojnë njohuri të përgjithshme me procedurat operative të luftimit të zjarreve në objektet e larta, shpëtimit e personave të ngujuar si dhe evakuimin e tyre në mënyrë profesionale dhe të sigurt.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do të marrin njohuri mbi luftimin e zjarreve në objektet e larta si: metodat dhe mënyrat e zhvillimit të zjarrit, metodat e leximit të tymit, mënyrat e ndryshme të evakuimeve emergjente, mënyrat e ventilimeve të ndryshme, mënyrat e përdorimit të litarëve etj.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë metodat dhe mënyrat e zhvillimit të zjarrit,
- bëjnë lidhjen e litarëve,
- bëjnë evakuimet emergjente,
- dinë të bëjnë ventilimin me shtypje në objektet e larta,
- dinë metodat e leximit të tymit.

Titulli i kursit: Hetimet e zjarrit

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 3 ditë (21orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit e SH.Z.SH të cilët e kanë të kryer Kursin Themelor dhe të Avancuar të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit. |
| Grupi i synuar: | Vetëm pjesëtarët e Shërbimeve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (SH.Z.SH) të cilët e ushtrojnë detyrën e zjarrfikjes dhe shpëtimit, nëpër shërbimet e tyre, inspektorët e mbrojtjes nga zjarri, inspektorët policor. |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit të fitojnë shkathtësitë, njohuri të nevojshme që të kenë mundësi të merren me sukses më Hetimet e Zjarrit (HeZ) në mënyrë të sigurt dhe efikase duke përdorur njohurit dhe teknikat e mundshme, pasi që zjarrfikësit ta shuajnë zjarrin duhet që ti ruajnë gjurmët e shkaktarëve të zjarrit që të bëhet një ekspertizë nga inspektorët e mbrojtjes nga zjarri dhe inspektorët policor.

Përshkrimi i kursit:

Gjatë këtij kursi pjesëmarrësit do të marrin njohuri mbi procesin e djegies dhe shuarjes së zjarrit, mbrojtjen dhe shikimin i vendit të ngjarjes gjatë hetimit të zjarrit duke mos i humbur gjurmët, gjatë fikjes së zjarrit, si dhe duke zbatuar masat parandaluese.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- dinë procesin e djegies dhe shuarjes së zjarrit,
- dinë si të fillojnë hetimet e zjarrit,
- bëjnë mbrojtjen dhe shikimin i vendit të ngjarjes,
- ruajnë provat e zjarrvënies & eksplozivet,
- përdorin masat preventive sipas standardeve,
- përdorin pajisjet laboratorike për hulumtimin e shkaqeve të zjarrit.

Shërbimi i korrektuesve të Kosovës - SHKK

I. Trajnimi bazik

Titulli i kursit: Zyrtari korrektues

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 6 javë (210 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit duhet të jenë të punësuar si oficerë korrektues nën Ministrinë e Drejtësisë |
| Grupi i synuar: | Të gjithë rekrutët e ri korrektues të caktuar |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i kursit, Ext 271 E-mai: course-admin@kps-s-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Pas përfundimit me sukses të kënaqshëm të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje t'i kryej detyrat e tij në institucionet e drejtësisë në mënyrë efektive.

Përshkrimi i kursit:

Ky kurs është themeli për Shërbimin Korrektues.

Të gjithë anëtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës duhet t'i nënshtrohen këtij kursi para se të angazhohen në institucione.

Janë pesë indikatorë kyç të përmbushjes së detyrave që e vlerësojnë studentin gjatë tërë kursit:

- vlerësimi i përmbushjes së detyrave në afatin e mesëm dhe final,
- provimi në ndihmën e parë – teori dhe praktikë,
- provimi për kontroll dhe përmbajtje – praktikë,
- testi final me shkrim.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- zotërojnë aftësi për tu ballafaquar me situata të ndryshme në një shoqëri kaotike,
- kenë shkathtësi për kryerjen e kontrolleve rutine në përputhje me parimet dhe procedurat ligjore si dhe marrjen e shënimeve mbi ndonjë parregullsi,
- dinë të bëjnë monitorimin e lëvizjes së të burgosurve duke i përcjell ata brenda dhe jashtë objektit,
- zotërojnë shkathtësi për analizimin e situatave parandaluese për peng-marrje,
- zotërojnë shkathtësi për analizimin e situatave parandaluese në rastet e tentim-vrasjes apo plagosjes nga ana e të burgosurve.

Titulli i kursit: Trajnimi special për shërbimin korrektues (stafi civil)

| | |
|-----------------------------|---|
| Kohëzgjatja: | 3 javë (105 orë) |
| Kushtet paraprake: | Pjesëmarrësit duhet të jenë të punësuar si oficerë korrektues me përvojë nën Ministrinë e Drejtësisë dhe të kalojnë testin me shkrim dhe intervistën me gojë. |
| Grupi i synuar: | Stafi i cili punon në institucionet korrektuese |
| Kontakti në QKSPEZH: | Administrimi i Kursit Ext. 271 E-mail: course-admin@kpss-ko.org |

Qëllimi i kursit:

Qëllimi i këtij trajnimi është të aftësoj SHKK përkatësisht stafin e burgjeve me njohuri për organizimin, menaxhimin, koordinimin, kontrollin e punës, obligimet dhe përgjegjësitë tjera organizativen në këtë institucion.

Përshkrimi i kursit:

Ky trajnim është i dizajnuar për t'i informuar dhe aftësuar personelin, në mënyrë që të respektohet ligji dhe rregulloret në objektet e burgut dhe në kontakt me të burgosurit dhe të menaxhohet sjellja e të burgosurve, me qëllim të përmirësimit sa më të suksesshëm të tyre.

Të priturat nga ky kurs:

Pas përfundimit të këtij kursi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- kryejnë obligimet dhe përgjegjësit organizative për të cilat janë të autorizuar,
- njohin dhe respektojnë ligjin dhe rregulloret që aplikohen në ambientet e burgut,
- menaxhojnë sjelljen e të burgosurve, etj.

Të gjitha kurset e mbajtura në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim

| 2010 | Emri i kursit |
|---|--|
| Trajnimi themelor | Basic Training |
| Shkathtësitë operative të Policisë | First Aid Responder |
| | Ricertification Course |
| Armët e zjarrit | Firearm Training Course Glock 9mm |
| | Rifel Training Course AK-47 |
| | Instructor Firearm Training |
| | Basic and Advance Firearm Taining Course MP5 |
| Trajnimet e specializuara dhe të avancuara | Basic Criminal Investigation Course |
| | Intelligence Course |
| | Advanced Investigation Course-CIC |
| | Specialized Investigation Course |
| | Basic Drugs Investigation Course |
| | Surveillance Course |
| | Basic Crime Scene Tech. (Forensic) |
| | Advanced Latent Print Course |
| | Human Trafficking Course |
| | First Aid and basic cardio life support |
| | Juvenile Delinquency Course |
| | Detention Centre Course |
| | Escorting Persons with hight risk |
| | Motorbike Course |
| | Basic Crowd Control |
| | Platoon Leader Course |
| | Medical Emergency |
| Curriculum Disign Course for Trainer | |
| Domestic Violence | |
| Trajnimet e Policisë Kufitare | Border Police Advanced Course |
| | Border Police Specialized Course |
| | Border Police Basic Course |
| Trajnimet e komunikacionit (trafikut) | Basic Emergency Vehicle Operation Course |
| | Traffic Management & Accident Investigation |
| | Radar, Laser and Breathalyzer Course |
| | Driving of Vehicle VW Golf 5-1.9 |
| | Traffic Safety |
| Trajnimet e menaxhmentit dhe mbikëqyrjes | 1st Line of Supervision |
| | Mid-Management |
| | Executive Course |
| | Training Needs Analysis |
| | Dealing with People&Task |

| | |
|--------------------------------|--|
| Standardet e trajnimeve | Field Training Officers KPS (KPS-FTO) |
| | Primary Field Training Officer (PFTO) |
| | Team Leader/Team Building/Conflict Management |
| | Non-verbal Communication |
| | Gender Equality Course |
| | Human Rights Awareness KPS |
| | Instructor training program |
| | Instructor training program |
| Departamenti i DME-së | Fire and Rescue Services-Professional Course |
| | Fire and Rescue 2 weeks - Basic Course |
| | Fire and Rescue 5 weeks - Basic Course |
| | Fire and Rescue – Advance Course |
| | Internal Fire Course |
| | Fire Fighting in Hight Building Course |
| | Fire Fighting Field-Mountain Course |
| | Specialized First Aid Course |
| | Fire Investigation Course |
| | Road Traffic Accident Course |
| | Using Fire-fight Device |
| | Inspector of MED Course |
| | Team Leader Course |
| | Shift Leader Course |
| | Dangerous Matter Course |
| | Basic Course in Rescu and diving under water |
| | GPS net Course |
| | Operator Course |
| | First Aid Course |
| Shërbimi Korrektues | Correction Basic Training |
| | Special Training for Correction Service (Civilian Staff) |
| Dogana e Kosovës | Procedures with Economic Impact |
| | Taric Training |
| | Special Control for Container, Truck with Trailer Course |
| | Non – Verbal Communication Course |
| | Human Rights Course |
| | Special Control for Bus Course |
| | Special Control for Aeroplane Course |
| | Special Control for Vehicles, Passengers and Luggage Course |
| | Treating the diplomatic Persons Course |
| | Risk Analysis, Selective Control, Protection of Society Course |
| | Special Training - Procedures with Economic Impact |
| | File Maintenance Course |
| | Transit and Movement of Wares Course |
| | Advance Training for implemantation of Customs Procedures |
| | Basic Training for TIMS |
| | Customs Crime Investigation Course |
| | Working Procedures Course |

| | |
|---|---|
| | Arrest and Detention Course |
| | Regulation U.2004/2 Course |
| Departamenti i trajnimeve të Policisë së Kosovës | Developing of Latent Prints with Chemicals |
| | First Aid Instructor Course |
| | Close Protection Course |
| | Advance Close Protection Course |
| | Instructor Course for Defensive Tactics |
| | Training for Field Commanders |
| | Training - Use of Gas Mask |
| | Special Intervening Team Training (SIT) |
| | Basic Investigation in Financial Offence Area |
| | Investigation of Corruption Course |
| | Introduction-Financial Crime Prevention |
| | Investigation of Frauds&Debtor Offences |
| | Investigation of Smuggling & Customs Revenue Offences |
| | Financial Analysis Course |
| | Anti-Money Laundering&Asset Tracing |
| | Directing Training on Financial Crime Investigation |
| | Investigation of Tax Offence |
| | Operational Analysis Course |
| | Basic Murder investigation Course |
| | Advance Murder investigation Course |
| | Fire/Arson Investigation Course |
| | Basic Counterterrorism Course |
| | Analyzing Source of Information Course |
| | Calculation and forensic auditation |
| | Murder, Blood, Shooting Analysis Scene Course |
| | IT Forensics for Financial investigation Crime |
| | Basic Calculation |
| | Latent Finger Print |
| | Basic Anti-organized Crime |
| | Forged Coins and documents course |
| Advance Community Policing | |
| Bike Course | |
| Identification of Diplomatic Vehicle | |
| Investigation for Explosive Device Course | |
| European Agency for Reconstruction - B&S Project | Introduction-Financial Crime Prevention |
| | Investigation of Counterfeiting |
| | Investigation of Smuggling & Customs Revenue Offences |
| | Investigation of Corruption |
| | Investigation of Tax Offence |
| | Financial Analysis |
| | Operational Analysis |
| | Investigation of Frauds&Debtor Offences |
| | Forensic Accountancy&Auditing |
| | Anti-Money Laundering&Asset Tracing |
| | Analysis IT Tools |
| | Basic Bookkeeping |

| | |
|--|--|
| | Train the Trainers |
| | Basic Training on Financial Crime Investigations |
| | Directing Training on Financial Crime Investigation |
| | Fire/Arson Investigation Course |
| | Analyzing Source of Information Course |
| | Crime Scene Technicians Course |
| Bilateral | First Aid Advanced Course |
| | Money Laundering |
| | Operational Analysis on Smuggling |
| | Geopolitical Issues, Causes&Reactions (ADA) |
| | IT for Investigators |
| | Project Management Course |
| | Marketing as a Strategy Instrument in the Police |
| | Crisis&Operations Management Training |
| | Train the Trainers |
| | Adv.Co.Comunity-Oriented Policing&Problem Solving |
| | Certification Tr.-Critical Incident Stress Management |
| | Financial Investigation in respect of Money Laundering |
| | Trafficking in Human Beings-Adv. Course |
| | Counter Terrorism Course |
| | Basic Homicide Investigation Course |
| Adv. Co. Community-Oriented Policing & Problem Solving | |

Kontaktet me Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim

| |
|---|
| Për ta thirrur receptionin e QKSPEZH-it: |
| 00381 (0)28 570 007 |
| 00381 (0)28 570 008 |
| 00381 (0)28 571 228 |
| |
| Numrat e faksit të QKSPEZH-it: |
| +381 (0)28 570 006 Zyra e Drejtorit |
| +381 (0)28 570 613 Zyra e Administratës |
| +381 (0)28 570 611 Zyra e Logjistikës |

Katalogu i kurseve të Qendrës së Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim iu siguron një pasqyrë të plan-programit tonë, me një përshkrim të shkurtër për çdo kurs. Nëse dëshironi informata të më tutjeshme ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni.

Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim
Vushtrri/Vucitrn

Numri i telefonit: +381 (0)28 570 007
Numri i faksit: +381 (0) 28 70 006

Botimi i njëmbëdhjetë, mars 2010

© 2010 Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH)

Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim
Rr. Gjergj Kastrioti Skënderbeu
Vushtrri / Vucitrn
Kosovë